

## GYKATA E QARKUT TË PRISHTINËS

P. NR. 514/08

23 Janar 2009

### NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut të Prishtinës, në trupin gjykues të përbërë prej:

- 1) Gjyqtar i EULEX-it, Z. Tron GUNDERSEN, në cilësinë e Kryetarit të Trupit Gjykues,
- 2) Gjyqtar i EULEX-it, Z. Andrea CRUCCIANI, në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues,
- 3) Gjyqtari Vendor, Z. Sylejman NUREDINI, në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues,

Të ndihmuar nga procesmbajtëset Jacqueline RYAN, Valentina GASHI dhe Vjora JOHNSTON;

Në çështjen penale kundër:

- 1 **Mehdi LIMANIT**, me pseudonimin “Gadafi”, lindur nga prindërit Gani (babai i tij) dhe Fatime (nëna e tij, mbiemri i saj i vajzërisë ka qenë Rexhaj), më 01/02/1960 në fshatin Balince, Komuna e Shtimjes, ku edhe jeton, i etnisë shqiptare, shtetas i Kosovës, i martuar, baba i gjashtë fëmijëve, ka kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, i padënuar më parë, dhe pa asnjë procedurë tjetër penale ndaj tij, përveç procedurës në fjalë, për momentin në paraburgim; të akuzuar për veprat penale të “Krimin të Organizuar” sipas Nenit 274, Paragrafët (1) dhe (2) lidhur me Nenin 327, Paragrafi (1) të KPPK; “Mbajtje e Pautorizuar e Armëve” sipas Nenit 328, Paragrafi (3) lidhur me Paragrafin (2) të KPPK;

- 2 **Skënder MAHMUTIT**, lindur nga prindërit Ramë (babai i tij) dhe Shabe (nëna e tij, mbiemri i saj i vajzërisë ka qenë Kalanica), më 20/05/1983 në fshatin Godancë, Komuna e Shtimjes, ku edhe jeton, i etnisë shqiptare, shtetas i Kosovës, statusi i tij familjar – begar, ka kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, i padënuar më parë, dhe pa asnjë procedurë tjetër penale ndaj tij, përveç procedurës në fjalë, për momentin në paraburgim shtëpiak; të akuzuar për veprën penale të “Krimin të Organizuar” sipas Nenit 274, Paragrafi (2) lidhur me Nenin 23 të KPPK, lidhur me Nenin 327, Paragrafi (2) të KPPK;

- 3 **Ramush KUTLESHIT**, lindur nga prindërit Sabri (babai i tij) dhe Hanife (nëna e tij, mbiemri i saj i vajzërisë ka qenë Arifi), më 02/10/1972 në fshatin Dumosh, Komuna e Podujevës, ku edhe jeton, i etnisë shqiptare, shtetas i Kosovës, statusi familjar – begar, ka kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, i padënuar më parë, për momentin në paraburgim shtëpiak; të akuzuar për veprën

penale të “Krimin të Organizuar” sipas Nenit 274, Paragrafi (2) lidhur me Nenin 23, lidhur me Nenin 328, Paragrafi (3) dhe Paragrafi (2) të KPPK, dhe Nenit 327 KPPK;

4 **Sami KUTLESHTT**, lindur nga prindërit Sabri (babai i tij) dhe Hanife (nëna e tij, mbiemri i saj i vajzërisë ka qenë Arifi, më 06/06/1977, në fshatin Dumosh, Komuna e Podujevës, ku edhe jeton, i emisë shqiptare, shtetas i Kosovës, statusi i tij familjar – i martuar, baba i tri fëmijëve, ka kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, i padënuar më parë, dhe pa asnjë procedurë tjetër penale ndaj tij, përveç procedurës në fjalë, për momentin në paraburgim shtëpiak; të akuzuar për veprën penale të “Krimin të Organizuar” sipas Nenit 274, Paragrafi (2) lidhur me Nenin 23, lidhur me Nenin 328, Paragrafi (3) dhe Paragrafi (2) të KPPK;

Pas mbajtjes së gjykimit kryesor të hapur për publikum më datat 13, 20, 21, 22 dhe 23 Janar 2009 dhe në prezencën e të gjithë të akuzuarve të përmendur më sipër, avokatëve të tyre mbrojtës dhe Prokurorit Publik Feti Tunuzliu;

Pas këshillimit dhe votimit të trupit gjykuës të mbajtur më 23 Janar 2009;

Duke u bazuar në Nenin 391, (1) KPPPK;

Shpall në publik dhe në prezencën e të akuzuarve, avokatëve të tyre mbrojtës dhe Prokurorit Publik, Aktgjykimin e mëposhtëm:

#### **AKTGJYKIM**

I akuzuari **Mehdi LIMANI**, me të gjitha të dhënat si më sipër:

#### **LIROHET**

Për veprën penale të “Krimin të Organizuar” sipas Nenit 274 (1) dhe (2) KPPK;

#### **SHPALLET FAJTOR**

Për veprën penale të tentativës së “Furnizimit, Transportimit, Prodhimit, Shkëmbimit dhe Shitjes së Paautorizuar të Armëve” sipas Nenit 327 (1) KPPK dhe Nenit 20 KPPK;

Megë:

- më 6 Mars 2008 ai tentoi t'i shiste një armë “M 48” personit “Faton”;
- më 6 Mars 2008 ai tentoi t'i shiste një pistoletë “TT” personit “Albert”;
- më 6 Mars 2008 ai tentoi t'i shiste një armë me silenciator dhe pajisje lufte personit “Luft”;

-më 7 Mars 2008 ai tentoi t'i shiste një armë "Skorpion" një personi të panjohur për çmimin 500 Euro;  
-më 9 Mars 2008 ai tentoi të blinte nga një person i panjohur 4 pako me plumba për pistoletën "TT";  
-më 9 Mars 2008 ai tentoi t'i shiste një armë zjarri të tipit 357 type, për çmimin 600 Euro personit "Genc";  
-më 9 Mars 2008 ai tentoi t'i shiste 100 copë plumba të armës "Kallash" një personi të panjohur;  
-më 10 Mars 2008 ai tentoi t'i shiste një armë zjarri të tipit "Skorpion" dhe 6 kartikatorë personit "Dulla";  
-më 14 Mars 2008 ai tentoi t'i shiste dy armë me silenciator personit "Luli";  
-më 15 Prill 2008 ai tentoi t'i shiste 70 plumba të një kalibri të panjohur personit "Bea";  
-më 20 Prill 2008 ai tentoi t'i shiste 40 plumba të një kalibri të panjohur personit "Ismet";  
-më 2 Maj 2008 ai tentoi t'i shiste 10 plumba një personi të panjohur;  
-më 22 Maj 2008 ai tentoi t'i shiste një pistoletë të prodhimit Italian për çmimin 330 Euro një personi të panjohur;  
-më 3 Qershor 2008 ai tentoi t'i shiste 6 pistoletë personit "Rifa";  
-më 29 Qershor ai tentoi të blinte 20 pako municione;  
-më 29 Korrik 2008 ai tentoi t'i shiste 20 plumba Skënder Mahmuti tek stacioni i benzines "Migroll" përgjatë rrugës Prishtinë-Ferizaj;

#### LIROHET

Nga aktet e mbetura të Seksionit I, Paragrafi të Aktakuzës;

#### SHPALLET FAJTOR

Për veprën penale të "Mbahjtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve" sipas Nenet 328 (2) dhe (3) KPPK;

Meqë:

-më 29 Korrik 2008 ai ka mbajtur pa leje të vlefshme për armët, armët e mëposhtme në shtëpinë dhe garazhin e tij:

- 1 Një pistoletë të tipit "Zastava", që mban numrin serial 9243J;
- 2 1.423 (një mijë e katërqind e njëzet e tre) plumba të kalibrave të ndryshëm;

I akuzuari Skënder MAHMUTI, me të gjitha të dhënat si më sipër:

#### LIROHET

Për veprën penale të “Krimin të Organizuar”, sipas Nenit 274 (1) dhe (2) KPPK;

#### SHPALLET FAJTOR

Për veprën penale të tentativës së “Furnizimit, Transportimit, Prodhimit, Shkëmbimit ose Shitjes së Paautorizuar të Armëve” sipas Nenit 327 (1) KPPK dhe Nenit 20 KPPK;

Megjë:

-më 29 Korrik 2008 tek stationi i benzinës “Migroll” që gjendet përgjatë rrugës Prishtinë-Ferizaj ai tentoi të blinte 20 plumba nga Mehdi Limani, por u kap nga policia përpara se të bëhej dorëzimi aktual;

I akuzuari Ramush KUTLESHI, me të gjitha të dhënat si më sipër:

#### LIROHET

Për veprën penale të “Krimin të Organizuar”, sipas Nenit 274, (1) dhe (2) KPPK;

#### LIROHET

Për veprën penale të “Furnizimi, transporti, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve” sipas Nenit 327 KPPK;

#### SHPALLET FAJTOR

Për veprën penale të “Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve” sipas Nenit 328, (2) dhe (3) KPPK;

Megjë:

-më 30 Korrik 2008 në shtëpinë e tij në fshatin Dumosh ai ka mbajtur armët dhe municionet e mëposhtme:

- 2 Një pistoletë “Beretta”;
- 3 Një pistoletë “Zastava”, me numër serial ET834037;
- 4 8526 (tetë mijë e pesëqind e njëzet e gjashtë) plumba të kalibrave të ndryshëm;

I akuzuari Sami KUTLESHI, me të gjitha të dhënat si më sipër:

#### LIROHET

Për veprën penale të “Krimin të Organizuar”, sipas Nenit 274, (1) dhe (2) KPPK;

### LIROHJET

Për veprën penale të “Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve” sipas Nenit 328, (2) dhe (3) KPPK;

### DËNIMI

#### Mehdi LIMANI:

Në bazë të Nenit 38 KPPK dhe Nenit 327, (1) dhe Nenit 20 KPPK, Mehdi Limani dënohet me burgim prej 2 vitesh e 6 muajsh.

Në bazë të Nenit 38 KPPK dhe Nenit 328, (2) dhe (3) KPPK, Mehdi Limani dënohet me burgim prej 1 viti e 6 muajsh.

Në bazë të Nenit 71 KPPK, dënimi unik për Mehdi Limanin është **3 vite e 6 muaj burgim.**

#### Skënder MAHMUTI:

Në bazë të Neneve 38 dhe 327, (1) dhe Nenit 20 KPPK, Skënder Mahmuti dënohet me **6 muaj burgim.**

#### Ramush KUTLESHI:

Në bazë të Neneve 38 dhe 328, (1) dhe (2) KPPK, Ramush Kutleshi dënohet me **1 vit burgim.**

Koha e kaluar në paraburgim apo paraburgim shtëpiak, siç aplikohet, përfshihet në masën e ndëshkimit të vendosur ndaj të gjithë të pandehurve.

### SHPENZIMET

Të pandehurit, Mehdi LIMANI, Skënder MAHMUTI dhe Ramush KUTLESHI duhet të paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale.  
Megjë të dhënat në lidhje me sasinë e shpenzimeve mungojnë, do të lëshohet një vendim i veçantë në lidhje me çështjen e shpenzimeve.

### ARSYETIMI

### PREJARDHJA PROCEDURIALE

Më 29 Korrik 2008, të pandehurit Mehdi LIMANI dhe Skënder MAHMUTI janë arrestuar dhe janë paraburgosur për një periudhë fillestare prej një muaji me anë të vendimit të Gjyqtarit të Proedurës Paraprake të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, ndërsa Ramush KUTLESHI dhe Sami KUTLESHI janë arrestuar më 30 korrik 2008 dhe janë paraburgosur gjithashtu për një periudhë fillestare prej një muaji me anë të vendimit të Gjyqtarit të Proedurës Paraprake të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës. Paraburgimi i të pandehurve është zgatur në mënyrë të ligjshme gjatë fazave të hetimit dhe konfirmimit.

Më 25 gusht 2008, Prokurori Publik ka dorëzuar në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës aktakuzën PP. Nr. 549-1/2008 kundër të pandehurve Mehdi LIMANI, Skënder MAHMUTI, Ramush KUTLESHI dhe Sami KUTLESHI, për veprat penale të mëposhtme:

I. Mehdi LIMANI:

- 1) Ai ka kryer një veprë penale të rëndë, të tillë si pjesë e një grupi të organizuar kriminal, në formë të tillë që për kryejten e këtyre veprave penale ai mund të dënohet deri në 4 vjet burgim. Ky grup ka ekzistuar për një periudhë të caktuar kohore dhe ata kanë bashkëvepruar me qëllim që të kryejnë vepra të rënda penale me qëllim që të përfitojnë prej tyre në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose jot ë drejtëpërdrejtë, dhe ata në mënyrë të vazhdueshme kanë kryer vepra të tilla penale, si: Furnizimi, Transportimi, Shkëmbimi dhe Shitja e Paligjshme e Armëve (Neni 327, Paragrafi (1) I KPPK, për të cilat ai mund të dënohet nga 1 deri në 8 vjet burgim. Në këtë mënyrë ai ka shitur armët si më poshtë vijon:
  - Më 05/ 03/ 2008 ai i ka shitur 30 plumba Shaban Bujës;
  - Më 05/ 03/ 2008 ai i ka shitur një personi të panjohur një sasi plumbash me vlerën prej 100 €;
  - Më 06/ 03/ 2008 ai i ka shitur një pistoletë "TT" Albert N nga fshati Kosharë;
  - Më 06/ 03/ 2008 ai i ka shitur një armë "M 48" Faton Qarrit të Kompanisë "IPKO";
  - Më 06/ 03/ 2008 ai i ka shitur një armë me silenciator dhe pajisje luftarake Luli N;
  - Më 07/ 03/ 2008 ai i ka shitur një personi të panjohur që ka marrë në telefon nga numri celular 044 662 808, një armë "Skorpion" për çmimin 500 €;
  - Më 07/ 03/ 2008 ai i ka shitur një sasi të panjohur armësh dhe municionesh Faton N nga fshati Dremnjak;
  - Më 09/ 03/ 2008 ai i ka shitur një personi të panjohur me numrin e telefonit celular 044 239-473, 4 pako me plumba për pistoletën "TT";
  - Më 09/ 03/ 2008 ai i ka shitur një armë të tipit 357, Genc N nga Shqipëria, me numër telefoni celular 044 433-522, për çmimin 600 €;
  - Më 09/ 03/ 2008 ai i ka shitur një personi të panjohur me numrin e telefonit celular 044 662-808, 100 copë plumba të armës "Kallash";

- Më 10/ 03/ 2008 ai i ka shitur një personi me pseudonimin "Dulla", me numër telefoni celular 044 527-969, një armë zjarri të tipit "Skorpion" dhe 6 karikatorë pistolete;
  - Më 14/ 03/ 2008 ai i ka shitur personit me emrin "Lulfi", me numër telefoni celular 044 497-811, 2 armë me silenciator;
  - Më 15/ 04/ 2008 ai i ka shitur një personi me pseudonimin "Bea", 70 plumba të një kalibri të panjohur;
  - Më 16/ 04/ 2008 ai i ka shitur personit me emrin Naser N, me numër celulari 044 664-800, një pistoletë të tipit "Beretta", për çmimin 300 €;
  - Më 20/ 04/ 2008 ai i ka shitur 40 plumba të një kalibri të panjohur Ismet N nga fshati Greme;
  - Më 02/ 05/ 2008 ai i ka shitur një personi të panjohur 10 plumba të tipit "7";
  - Më 19/ 05/ 2008 ai ka shitur një pako me plumba për pistoletën "TT";
  - Më 22/ 05/ 2008 ai i ka shitur "djalin të Emnirit", një pako me barut për armën M-48;
  - Më 22/ 05/ 2008 ai i ka shitur një personi të panjohur 50 plumba të armës M-48;
  - Më 22/ 05/ 2008 ai i ka shitur një personi të panjohur një pistoletë të prodhimit Italian, për çmimin 330 €;
  - Më 23/ 05/ 2008 ai i ka shitur një personi të panjohur një armë për një çmim të pacaktuar;
  - Më 25/ 05/ 2008 ai i ka shitur Kasim N, një sasi plumbash, për çmimin 50 €;
  - Më 01/ 06/ 2008 ai i ka shitur një personi të panjohur 25 plumba të një arme pistoletë;
  - Më 03/ 06/ 2008 ai i ka shitur një personi me pseudonimin "Rifa", 6 armë pistoletë;
  - Më 08/ 06/ 2008 ai i ka shitur një personi të panjohur 16 plumba;
  - Më 08/ 06/ 2008 ai i ka shitur Agim N, 40 plumba të pistoletës "TT";
  - Më 15/ 06/ 2008 ai i ka shitur një personi të panjohur 2 pistoleta "TT";
  - Më 21/ 06/ 2008 ai i ka shitur Rrahman N, 20 plumba të pistoletës "TT";
  - Më 23/ 06/ 2008 ai i ka shitur një personi me pseudonimin "Ceni", një pistoletë, për çmimin 300 €;
- Dhe më 29/ 06/ 2008 atij i janë dhënë 40 pako me municione luftarake, brenda grupit të përbërë prej personave të sipërpërmendur, i cili ishte ngritur për qëllimin e tregëtisë së armëve, ku i pandehuri Mehdi Selmani përmes shifjes së armëve dhe municioneve, ndërsa anëtarët e tjerë të grupit kanë blerë përmes tij, dhe kanë vazhduar kontrabandimin e armëve me qëllim që të kishin përfitim material.
- përmes kësaj ai ka kryer veprën penale të "Krimin të Organizuar", sipas Nenit 274, Paragrafi (1) lidhur me Nenin 327, Paragrafi (1) të KPPK.

- 2) Deri më datën 29/ 07/ 2008 ai ka mbajtur pa leje të vlefshme një sasi të madhe armësh, kështu ai ka mbajtur në shtëpinë e tij një pistoletë të tipit "Zastava", me numër serie nr. 9243J, ndërsa në garazhin e tij ai ka mbajtur një sasi të

përgjithshme prej 1.423 plumbash të kalibrit 7.62mm; 7.62 mm me mbishkrimin II 65; plumba me gaz, të kalibrit 7.62mm, të kalibrit 9mm, të kalibrit 7.62 mm, të kalibrit 7.62mm me mbishkrimin II 64 dhe të kalibrit 6.35mm.

- përmes së cilës ka kryer veprën penale të “Mbajtjes në pronësi në mënyrë të pautorizuar të armëve”, sipas Nenit 328, Paragrafi (3) lidhur meParagrafin (2) të KPPK.

## II. Mehdi LIMANI dhe Skënder MAHMUTI

-Duke pasur një marrëveshje të mëparshme me njëri-tjetrin, ata kishin marrë pjesë në mënyrë aktive në veprat penale të grupit të organizuar kriminal, duke qenë të ndërjegjishëm që pjesëmarrja e tyre do të kontribuonte në kryerjen e veprave të rënda penale me anë të zbatimit të marrëveshjes së aritur, e cila ishte si më poshtë vijon:  
Më 29/ 07/ 2008 Skënder Mahmuti, me vullnetin e tij të lirë, u largua nga shtëpia e tij në fshatin Godancë, Komuna e Shtimjes, dhe shkoi në stacionin e benzinës “Milgroll Petroli” që gjendet përgjatë rrugës Prishtinë- Ferizaj, dhe në orën 16:00 së bashku me Ramadan N kanë kontaktuar të pandehurin tjetër, Mehdi Limani, i cili ishte thirrur më herët nga Ramadan N të transportonje pa autorizim 37 plumba të kalibrit 7.65 mm në atë vend meqë ata kishin një urdhër bletrijeje (porosi) nga Liridon Gashi nga fshati Godancë, Komuna e Shtimjes, më pas të transportonin pa autorizim këta plumba në shtëpinë e tij në fshatin Godancë me anë të automjetit “Jeep-Opel Frontera”, duke vazhduar kështu kontrabandimin, përmes së cilës ata kanë kryer veprën penale të “Furnizimit, Transportimit dhe Shitjes së Paautorizuar të Armëve”, sipas Nenit 327, Paragrafi (2) të KPPK, dhe në bazë të këtij neni ata mund të ndëshkohen nga 1 deri në 8 vjet burgim.

- përmes së cilit, në bashkëpunim, ata kanë kryer veprën penale të “Krimin të Organizuar” sipas Nenit 274, Paragrafi (2) lidhur me Nenin 23 të KPPK, lidhur me Nenin 327, Paragrafi (2) të KPPK.

## III. Mehdi LIMANI dhe Ramush KUTLESHI

Më 27/ 07/ 2008 i pandehuri Ramush Kutleshi ka transportuar pa autorizim 10 pako me plumba të kalibrit 9mm, 10 pako me plumba të kalibrit 7mm, 5 pako me plumba të kalibrit 6mm, nga shtëpia e tij në fshatin Dumosh, Komuna e Podujevës, në një vend në Prishtinë, dhe më pas ia ka shitur ato pa autorizim të pandehurit Mehdi Limani. Pastaj, ky i fundit, pasi i ka siguruar sendet në fjalë, të nesërmen, më 28/ 07/ 2008, në shkëmbim i ka dhënë 1.150 € Bujar N, një punonjësi të dyqanit “Te Bashkimi” pranë stacionit të benzinës “Hib Petrol”.

- përmes së cilës secili prej tyre ka kryer veprën penale të “Furnizimit, Transportimit dhe Shitjes së Paautorizuar të Armëve”, sipas Nenit 327, Paragrafi (2) lidhur me Paragrafin (1) të KPPK.

## IV. Ramush KUTLESHI dhe Sami KUTLESHI

Megë personat e panjohur, sipas negociatave të mëparshme me të pandehurit, kanë furnizuar me armë dhe municione pa autorizim të pandehurit Ramush Kutleshi dhe Sami

Kutleshi duke sjellë arsenalin e madhë të luftës në shtëpinë e këtyre dy të fundit, në fshatin Dumosla, Komunë e Podujevës, kështu që u sollën sendet e mëposhtme: një pistoletë “Beretta” e modelit 950 B, e kalibrit 6.35mm; një pistoletë “Zastava”, me numër serie nr. ET 834037; 8526 plumba të kalibrave të ndryshëm: 7.62 x 25 mm; 7.62 x 39 mm; 7.665mm; 7.92 x 57 mm; 6.35 mm and 9x19mm. Të pandehurit Ramush Kutleshi dhe Sami Kutleshi, duke qenë tërësisht të ndërgjegjshëm kanë vazhduar të posedojnë sasinë e përmendur të armëve pa pasur asnjë leje të vlefshme për to, deri më 30/ 07/ 2008, duke i ruajtur ato brenda një dhome (magazine), në automjetin “Golf 2” dhe në një djeq, me qëllim që të kryenin së bashku veprën penale të “Posedimit të Pautorizuar të Armëve”, sipas Nenit 328, Paragrafi (3) lidhur me Paragrafin (2) të KPPK, ku parashikohet një dënim nga 1 deri në 10 vite burgim, dhe nga kjo kontrabandë, të pandehurit kishin për qëllim që të fitonin para.

-përmes së cilës të pandehurit Ramush Kutleshi dhe Sami Kutleshi, në bashkëpunim, kanë kryer veprën penale të “Krimin të Organizuar”, sipas Nenit 274, Paragrafi (2) lidhur me Nenin 23, lidhur me Nenin 328, Paragrafi (3) dhe Paragrafi (2) të KPPK.

Më pas, aktakuza u konfirmua më datën 8 shtator 2008 nga Gjyqtari Konfirmues i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, Shëmsi HAJDINI.

Më 13 janar 2009, filloi gjykimi kryesor. Morën pjesë Anëtarët e Trupit Gjykses, siç janë përmendur më sipër; i pandehuri Mehdi LIMANI dhe Avokatët e tij Mbrojtës, Flamur BOGAL/Bahir TROSHUPA; Skënder MAHMUTI dhe Avokati i tij Mbrojtës, Azem VILLASI; Ramush KUTLESHI dhe Avokati i tij Mbrojtës, Hamdi PODVORICA; Sami KUTLESHI dhe Avokatja e tij Mbrojtëse, Besime ISMAILI. Juridiksioni i Gjyqtarëve të EULEX-it në këtë çështje bazohet në dispozitat e Nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Juridiksionin, Përzgjedhjen e Çështjeve dhe Çaktimin e Lëndëve Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, dhe Nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-052 mbi Zyrën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, ku përkatësisht thuhet që “Gjyqtarët e EULEX-it të cilët caktohen në procedurat penale do të kenë juridiksionin dhe kompetencën mbi çdo çështje që hetohet apo ndiqet penalisht nga ZPSK” dhe që “ZPSK do të ketë kompetencën ekskluzive për të hetuar dhe gjedkur penalisht veprat e mëposhtme penale, gjithashtu edhe në formën e tentativës, dhe formave të ndryshme të bashkëpunimit për veprat penale të:.....n) krimin të organizuar (Neni 274, KPPK)”. Nuk ka pasur asnjë kundërshtim nga palët në lidhje me përbërjen e trupit gjykses.

Gjatë së njëjtës seancë, pasi u lexua çdo akuzë e aktakuzës nga ana e Prokurorit Publik, të pandehurit u pyetën nëse e deklaronin veten fajtorë apo të pafajshëm. I akuzuari Mehdi LIMANI u deklarua i pafajshëm në lidhje me akuzën I, Paragrafi 1), Akuzat II dhe III, dhe ai e deklaroi veten fajtor për akuzën I, Paragrafi 2); I pandehuri Skënder MAHMUTI e ka deklaruar veten të pafajshëm; I akuzuari Ramush KUTLESHI e ka deklaruar veten të pafajshëm për akuzën III dhe pjesërisht fajtor për akuzën IV, sipas Nenit 328, por jo sipas Nenit 274 të KPPK; I akuzuari Sami KUTLESHI e ka deklaruar veten të pafajshëm.

Në lidhje me propozimin e avokatëve mbrojtës të të gjithë të pandehurve për të ndërprerë paraburgimin e caktuar ndaj tyre, dhe pasi u dëgjua mendimi i Prokurorit Publik, Trupi Gjykses vendosi me anë të një vendimi të veçantë të konfirmojë

paraburgimin e caktuar kundër të pandehurit Mehdi LIMANI dhe të ndëpresë paraburgimin e caktuar kundër të gjithë të pandehurve të tjerë, duke vendosur ndaj tyre masën e paraburgimit shtëpiak, në bazë të Neneve 268, Paragrafët 3 dhe 4, dhe 278 të KPPPK.

Më datën 20 janar 2009, u morr në pyetje dëshmitari Haki BERISHA.

Më datën 21 janar 2009, Prokurori Publik lexoi dokumentet përkatëse në lidhje me interceptimet telefonike. Pastaj u vazhdua me martjen në pyetje të të pandehurit Mehdi LIMANI.

Më datën 22 janar 2009, seanca vazhdoi me martjen në pyetje të të pandehurve Mehdi LIMANI, Skënder MAHMUTI, Ramush KUTLESHI dhe Sami KUTLESHI. Gjithashtu u dëgjuan edhe fjalët përfundimtare të të gjitha palëve.

Më datën 23 janar 2009, Prokurori Publik paraqiti urdhërin për zgjatjen e interceptimit të telekomunikimit, i cili është bërë pjesë e dosjes së gjykatës. Trupi Gjykses u tërhoq për procesin e këshillim-votimit. Më pas, Trupi Gjykses, pas procesit të këshillim-votimit, ka shpallur dispozitivin e mësipërm në formë të shkruar të aktgjykimit.

## **MERTAT E ÇËSHITJES**

### **1. Lirimi i të gjithë të pandehurve për akuzën e krimit të organizuar.**

Në aktakuzë dhe gjatë gjykimit kryesor, Prokurori Publik ka tentuar ta bindë këtë Trup Gjykses se i pandehuri Mehdi LIMANI ka qenë një anëtar aktiv i një organizate kriminale – anëtarë të së cilës kanë qenë gjithashtu edhe të pandehurit e tjerë Skënder MAHMUTI, Ramush KUTLESHI dhe Sami KUTLESHI – që merreshin me gjetjen e armëve. Pavarësisht nga kjo, Prokurori Publik, mbi të cilin rëndon edhe barra e provave, në bazë të Nenit 10, Paragrafi 3, të KPPPK, ka dëshuar plotësisht të mbështesë me ndonjë provë ekzistencën e një organizate të tillë kriminale.

Neni 274, Paragrafët 1 dhe 2, të KPPK inkriminojnë përkatësisht “*Kushdo që kryen krim të rëndë si pjesë e një grupi të organizuar kriminal*” (Paragrafi 1) dhe “*Kushdo që aktivisht merr pjesë në aktivitete kriminale ose në aktivitete të tjera të një grupi kriminal të organizuar, duke e ditur se pjesëmarrja e tij do t'i kontribuojë kryerjes së krimeve të rënda nga grupi kriminal i organizuar*” (Paragrafi 2).

Neni 274, në Paragrafin 7, vazhdon të sqarojë përkufizimet ligjore të termave përkatës që përmenden në Paragrafët e mësipërm. Në veçanti, shprehja “krim i organizuar” do të thotë krim i rëndë i kryer nga ndonjë grup i strukturuar për të përfutur drejtpërsëdrejti ose tërthorazi dobi pasurore a financiare; Shprehja “*grup kriminal i organizuar*” do të thotë grup i strukturuar i cili ekziston për një kohë të caktuar dhe i cili vepron në bashkëpunim me qëllim të kryerjes së një ose më shumë krimeve të rënda për përfitim të drejtëpërdrejtë ose tërthortë të dobisë pasurore apo financiare; shprehja “*krim i rëndë*” do të thotë një veprë penale e ndëshkueshme me të paktën 4 vjet burgim; Shprehja “*grup i strukturuar*” do të thotë grup prej tre ose më shumë personave i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e

atypëratyshme të ndonjë vepre penale dhe nuk do të thotë formalisht r'i ketë të përkufizuar rolët për anëtarët e tij, vazhdimësinë e anëtarësisë së tij apo strukturën e zhvilluar.

Tani, duke u bazuar në dispozitat e Nenit 274 të KPPK është e sigurt të pohohet që të kryhet një krim i organizuar janë të nevojshme elementët e mëposhtëm: 1) elementi material (*actus rei*), që është kryerja e një vepre të rëndë penale (e ndëshkueshme me të paktën 4 vite burgim) si një pjesë e një grupi të organizuar kriminal apo pjesëmarrja në veprimtaritë kriminale apo veprimtaritë e tjera të një grupi të organizuar kriminal, duke e ditur që pjesëmarrja e tij apo e saj do të kontribuojë në kryerjen e veprave të rënda penale nga grupi i organizuar kriminal; 2) ekzistenca e një grupi të organizuar kriminal, kjo do të thotë e një grupi të strukturuar – një grupi prej tri apo më shumë personash që nuk formohet rastësisht për kryerjen e atypëratyshme të ndonjë vepre penale dhe që nuk ka nevojë të përcaktojë formalisht rolet për anëtarët e tij, vazhdimësinë e anëtarësisë apo të ketë një strukturë të zhvilluar – ekzistenca për një periudhë kohore dhe të vepruarit në bashkëpunim me qëllimin për të kryer një apo më shumë krimeve të rënda me qëllim që të kenë, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë përfitim të dobisë pasurore apo financiare; 3) elementi psikologjik (*mens rea*) në formën e një qëllimi të kualifikuar (*dolus specialis*), që do të thotë njohuritë që kryerja e një krimi të rëndë (*id est*, vepra penale për të cilën flitet) apo pjesëmarrja në një grup të organizuar kriminal bëhet në bashkëpunim me anëtarë të tjerë të grupit në fjalë me qëllimin për të kryer një apo më shumë krime të rënda, me qëllim që të kenë, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë përfitim të dobisë pasurore apo financiare.

Grupi Gjykuës mendon se Prokurori Publik ka dështuar plotësisht të japë çfarëdo prove në lidhje me elementët e përmendur, në veçanti, që asnjë provë nuk është sjellë për vëmendjen e këtij Grupi Gjykuës që të sugjerojë që të pandehuri kanë genë pjesë e një grupi të organizuar kriminal. Në të vërtetë, nuk është paraqitur asnjë provë në lidhje me strukturën e grupit kriminal, kohën kur ai ka qenë aktiv, dobiet pasurore apo financiare të tij, e kështu me rradhë. Përkundrazi, duket qartë nga administrimi i provave gjatë shqyrtimit kryesor se Skënder MAHMUTI nuk dinte gjë për ndonjë të pandehur tjetër, përpara fillimit të procedurës së tanishme penale, dhe se Sami KUTLESHI gjithashtu nuk e njihje Skënder MAHMUTIN dhe Mehdi LIMANIN.

Duke përfunduar, pasi kemi marrë në konsideratë mungesën e plotë të provave në lidhje me akuzën e "Krimin të Organizuar", sipas Nenit 274 të KPPK, të gjithë të pandehurit do të lirohen në lidhje me këtë akuzë.

## **2. Përgjegjësia penale e Mehdi LIMANIT.**

Ky Grup Gjykuës pamëdyshje ka vërtetuar përgjegjësimë penale të të pandehurit Mehdi LIMANI, në lidhje me veprat penale të Tentativës së "Furrizimi, transporti, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve", sipas Nenit 327 (1) dhe 20 të KPPK dhe "Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve", sipas Nenit 328 (2) dhe (3) të KPPK.

**2.1. Tentativa e "Furrizimi, transporti, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve", sipas Nenit 327 (1) dhe 20 të KPPK.**

## **2.1.1. Akuzat, Paragrafi 1), e Aktakuzës.**

Përsa i përket akuzës së “Furnizimi, transporti, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve”, Trupi Gjykses konstaton se përgjegjësia penale ë të pandehurit Mehdi LIMANI do të kufizohet në një “tentative” për të kryer një veprë të tillë penale, megjë Prokurori Publik nuk ka genë në gjendje të demonstrojë që shkëmbimi dhe shitja e armëve apo municioneve, të cilave iu referohen disa nga telefonatat e interceptuara, në fakt nuk kanë ndodhur. Për më tepër, edhe në formën e një “tentative”, disa nga shkëmbimet dhe shitjet të cilat përmenden në aktakuzë, nuk janë provuar që të kenë ndodhur fare.

Burimet kryesore të provave mbi të cilat mund të mbështetet Trupi Gjykses janë rezultatet e interceptimeve të telefonatave në lidhje me numrin 044201844, në përdorim nga i pandehuri Mehdi LIMANI. Masat e fshehta mbi interceptimin e telekomunikimeve janë urdhëruar në mënyrë të ligjshme me anë të një vendimi të Gjyqtarit të Procedurës Paraprake të lëshuar më 4 mars 2008 dhe që është zgjidhur më vonë nga i njëjti Gjyqtar. Telefonatat përkatëse të interceptuara janë lexuar gjithashtu edhe gjatë gjyqimit kryesor të hapur për publikun, në seancën e zhvilluar më 21 janar 2009.

Numri i telefonit i interceptuar 044201844 është njohur që të jetë ai i përdorur nga Mehdi LIMANI gjatë periudhës kohore të përcaktuar në aktakuzë, nga i njëjti i pandehur. Kjo është pjesa përkatëse e marrë nga procesverbali i seancës së zhvilluar më 21 janar 2009:

**Prokurori Publik:** *Sa numra keni dhe cilët janë ata?*

**Mehdi Limani:** *Unë kam dy; 044 201844 dhe tjetri është i vëllait tim, që punon me mua në një kompani autobusësh, dhe numri i tij është 044 608010....(higel)....*

**Kryetari i Trupit Gjykses:** *Më duhet të qartësoj. A mund të qartësoni, ju lutem, edhe një herë numrin tuaj të parë?*

**Mehdi Limani:** *044201844....(higel)....*

**Andrea Cruciani:** *Një qartësim, në lidhje me interceptimin. A është numri i telefonit 044 201 844, ai numër që keni pasur në përdorim gjatë periudhës Mars deri në Korrik 2001?*

**Mehdi Limani:** *Unë e kam pasur këtë numër që në vitin 2001.*

**Andrea Cruciani:** *Pra, ju po konfirmimi se e keni përdorur atë?*

**Mehdi Limani:** *Po.*

Në disa biseda telefonike i bëhet referencë një personi me emrin “Gadafi” apo “xhaxha Gadaf”. Ky është pseudonimi i të pandehurit Mehdi LIMANI, siç e ka pranuar edhe ai gjatë marrjes së tij në pyetje në gjykatë në datën 21 janar 2009.

Një pjesë e nxjerrë nga procesverbali i seancës së zhvilluar më 21 janar 2009:

**Prokurori Publik:** *A keni ndonjë pseudonim?*

**Mehdi Limani:** *Po, Gadafi.*

Duke u bazuar në interceptimin e përmendur të telekomunikimeve, përgjegjësia penale e Mehdi LIMANIT për të tentuar të shesë apo të blejë armë është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm në lidhje me incidentet e mëposhtme:

1 më 6 mars 2008 ai tentoi t'i shiste personit "Faton" një armë "M 48".

Integrali i telefonatës së interceptuar nga ora 15:00:42 deri në orën 15:01:44 nga telefoni celular i të pandehurit (044201844) drejtuar personit të quajtur Faton (049890796) i referohet gatisisht një arme M48:

Fatoni: ej, kam një të gjatë;

Mehdiu: çfarë?

Fatoni: do e marrësh apo jo, dyzet e tetë (48);

Mehdiu: në rregull?

Fatoni: jo dhe aq por është e mirë, një e re;

Mehdiu: sa kushton?

Fatoni: në të vërtetë nuk di çfarë të them, jam në një situatë të keqe, dua të them për ty dyqind (200), do të ta jap.

2 më 6 mars 2008 ai tentoi t'i shiste personit "Albert" një pistoletë "TT".

Këtu është telefonata përkatese e interceptuar, e cila tregon tentativën për t'ia shitur pistoletën "TT" personit "Albert":

Transkriptimi II			
Nr. i telefonit të interceptuar	Telefonata nr.	Emri i Operacionit	
44201844			
Data	Telefonata fillon	Kohëzgjatja e telefonatës	Telefonata përfundon
06/03/2008 10:42:32	06/03/2008 10:40:32	0:01:34	06/03/2008 10:41:06
Tipi i Telefonatës: Zëri	SMS	Po	Jo
Numri i Telefonit të Kontaktuar		Parapaguesi	
Thirrur: 44201844			
Numri që ka marrë në telefon: 44652666			
Personi që ka përdorur telefonin e interceptuar		Personi që ka kontaktuar	
Mehdiu		Alberti	
Ka tentuar të telefonojë		Po	
Telefonata e përshatshme		Po	

Përmbledhje  
Fjalë për fjalë

Po  
Po

Jo  
Jo

Alberti: axha Gadaf, a u lodhe?

Mehdiu: pak po ti?

Alberti: Alberti, jam nga Koshtara, (jo shumë e kaprueshme)

Mehdiu: Po Albert?

Alberti: çfarë po bën, si je?

Mehdiu: Mirë, shumë

Alberti: a po fle?

Mehdiu: Jo, po pi çaj  
 Alberti: Doja të të pyesja diçka. Më ka pyetur një shoku im. Atij i duhet një revolver TT  
 Mehdiu: Aha, po  
 Alberti: A ke ndonjë të re?  
 Mehdiu: Në të vërtetë jo  
 Alberti: Dikush tha që ka në Shtime  
 Mehdiu: Në të vërtetë jo, jo një të re, të betohem që s'ka të re  
 Alberti: Jo të re?  
 Mehdiu: Jo, jo  
 Alberti: e të përdorurat sa janë, axha Gadaf?  
 Mehdiu: jo nën pesëqind (500) euro, dhe unë nuk e kam për momentin. Kam të tjera, por jo ato.  
 Alberti: për pesëqind (500)?  
 Mehdiu: po, po  
 Alberti: në rregull është  
 Mehdiu: në rregull, mirupafshim  
 Alberti: Mirupafshim.

DATA	KOHA	OFFICERI (emri dhe firma)	LA
23 – Prill – 08	13.53	Skorpion	Banda

3 më 6 mars 2008 ai tentoi t'i shiste një armë me silenciator dhe pajisje lufte personit "Luli".

Këtu është telefonata përkatëse e interceptuar, e cila i referohet tentativës për t'ia shitur armën eme silenciator dhe pajisjet e luftës "Luli":

Transkriptimi LI			
Nr. i telefonit të interceptuar	Telefonata nr.	Emri i operacionit	
44201844			
Data	Telefonata fillon	Kohëzgjatja e telefonatës	Telefonata përfundon
06/03/2008 19:32:47	06/03/2008 19:32:47	0:00:42	06/03/2008 19:33:29
Numri i Telefonit të kontaktuar		Parapaguesi	
Thirrur: 44201844			
Numri që ka thirrur: 44413895			
Personi që po përdor telefonin e interceptuar		Personi i kontaktuar	
Mehdiu		Luli	
Telefonatë e tentuar		Po	
Telefonatë përkatëse		Po	

Përmbledhje  
 Fjalë për fjalë

Po  
 Po

Jo  
 Jo

Luli: Ç'kemi!  
 Mehdiu: Ç'kemi!  
 Luli: Ato i mbajnë bashkë, bashkë  
 Mehdiu: në rregull, në rregull  
 Luli: në rregull?  
 Mehdiu: të dyja, bashkë?

Luli: çfarë?  
Mehdiu: të dyja, që ta mbajë atë?  
Luli: po, silenciatorin me to, po  
Mehdiu: Kur do vijë ai, kur?  
Luli: Ai vien në fund të muajit, kështu ka thënë  
Mehdiu: në rregull është, ku je ti tani?  
Luli: mirupafshim  
Mehdiu: mirupafshim

Data	Koha	Oficeri (emri dhe firma)	LA
23 – Prill – 08	13.54	skorpion	

4 më 7 mars 2008 ai tentoi të shiste një armë “Skorpion” për çmimin 500 Euro tek një person i panjohur.

Kjo pason një telefonatë të interceptuar, e cila i referohet një tentative për të shitur një armë “Skorpion” për 500,00 Euro:

Numri që interceptohet 044201844; Data: 07/03/2008; Koha: 11:14:35 – 11:15:18:

PPM: çfarë po bën?  
Mehdiu: Jam këtu në restorant.  
PPM: Po, po!  
Mehdiu: Po  
PPM: a e ke atë, të verdhën?  
Mehdiu: eh?  
PPM: të verdhën, a e ke?  
Mehdiu: po.  
PPM: për sa e shet?  
Mehdiu: Shite sat ë duash, nuk ma ndien  
PPM: a e di cilën?  
Mehdiu: Po, po  
PPM: skorpionin  
Mehdiu: po, po, po, mos fol, e di  
PPM: sa e shet për ne?  
Mehdiu: po, pesëqind (500) Euro, çmimi i fundit, duke përfshirë edhe “të folurën” (që do të thotë “gjënë”)  
PPM: cilën “gjë” jletër?  
Mehdiu: Ka edhe një “gjë” jletër qëll bashkëngjitet asaj, kështu, i bashkëngjitet asaj, e di?  
PPM: po  
Mehdiu: a e di?  
PPM: Po, po, po, po  
Mehdiu: ajo po i bashkëngjitet asaj, vecmas, përveç asaj, nëse do t’ia shtosh  
PPM: sa, çmimi i fundit, çmimi i fundit, sa?  
Mehdiu: pesë, çmimi i fundit, pesëqind (500)  
PPM: po? Në rregull  
Mehdiu: po  
PPM: mirë, do t’ia tregojmë këtë dikujt tani  
Mehdiu: mirupafshim.

5 më 9 mars 2008 ai tentoi të blinte nga një person i panjohur 4 pako me plumba për një pistoletë “TT”.

Integrali i telefonatës së interceptuar nga ora 11:09:04 deri në orën 11:09:04 nga telefoni celular i të pandehurit (044201844) drejtuar një personi të panjohur (044239473) i referohet tri apo katër kutive me plumba për pistoletën “TT”.

Mehdiu: më sill tri-katër kuti me plumba TT në asfalt.

- 6 më 9 mars 2008 ai tentoi t'i shiste një armë zjarri të tipit 357, për çmimin 600 Euro personit “Genc”.

Integrali i telefonatës së interceptuar nga ora 16:40:34 deri në orën 16:42:08 të pranuar nga telefoni celular i të pandehurit (044201844) nga personi i quajtur Genc (044433522) ka të bëjë me një armë të tipit 357, me një vlerë prej 600 Euro:

PPM: një 357 e re, fare e re, sa kushton sipas teje?

Mehdiu: 600 Euro;

PPM: pagova 800 për të, është e re fringo;

Mehdiu: nuk mund të shitet për më shumë se 6-7 qind;

- 7 më 9 mars 2008 ai tentoi t'i shiste një personi të panjohur 1000 copë plumba të armës “Kallash”.

Integrali i telefonatës së interceptuar nga ora 22:01:20 deri në orën 22:02:56 të pranuar nga telefoni celular i të pandehurit (044201844) nga një person i panjohur (044662808) ka të bëjë me shifren e 1000 copë plumbave të armës “Kallash” për 30 centë copa:

PPM: a i ke ato të;

Mehdiu: kam aq sat ë duash ti;

PPM: sa për t'i dhënë dikujt 1000 copë;

Mehdiu: me 30 centë. Sa të duash.

- 8 më 10 mars 2008 ai tentoi t'i shiste personit të quajtur “Dulla” një armë zjarri të tipit “Skorpion” dhe 6 karikatorë pistolete.

Integrali i telefonatës së interceptuar nga ora 10:11:18 deri në orën 10:12:43 pranuar nga telefoni celular i të pandehurit (044201844) nga personi me pseudonimin Dulla (044527969) i referohet shifres së armës të tipit skorpion dhe 6 karikatorëve:

Dulla: ej, çfarë ndodhi djë, personi e provoi atë, edhe unë e provova me një 3-4 breshëri të shtënash automatike;

Mehdiu: të betohen Dullë që nuk e di, nuk e besoj që ndodhi ashtu, a më dëgjoni; ... (tinget)...

Dulla: ej, e për atë skorpionin a i gjetë karikatorët për mua?

Mehdiu: Jo të betohen, ato mezi gjenden, është e vështirë t'i gjesh ato;

Dulla: e për këto a ke karikatorë?

Mehdiu: për cilat?

Dulla: për revolverët;

Mehdiu: po, ka diçka;

Dulla: sa copë mund të gjesh për mua, a mund të gjesh 2-3 për mua?

Mehdiu: Për ty mund të gjej 5 apo 6;

Dulla: sa kushtojnë ato?

Mehdiu: po, 20 Euro, ato kushtojnë 25, port y po t'i jap për 20.

9 më 14 mars 2008 ai tentoi t'i shiste dy armë me silenciator personit të quajtur "Luli".

Integrali i telefonatës së interceptuar nga ora 10:34:08 deri në orën 10:34:46 pranuar nga telefoni celular i të pandehurit (044201844) nga personi i quajtur Luli nga Budakova (044264827) ka të bëjë me shifren e dy armëve me silenciator.

Luli: mbaje atë bashkë me tjetrën, mbaji të dyja;  
Mehdiu: në rregull në rregull;... (hiqet) ....  
Luli: të dyja, silenciatorin bashkë me të, po;  
Mehdiu: kur vjen ai, kur?

10 më 15 prill 2008 ai tentoi t'i shiste 70 plumba të një kalibri të panjohur personit të quajtur "Bea".

Integrali i telefonatës së interceptuar nga ora 19:27:38 deri në orën 19:28:46 pranuar nga telefoni celular i të pandehurit (044201844) nga personi i quajtur "Bea" (044201844) i referohet 70 plumbave:

Beha: sa kushon paketa?  
Mehdiu: me kë po flas?  
Beha: ah, me Behan  
Mehdiu: Beha, ti e di që është pesëdhjetë me pesëdhjetë (50-50)  
Beha: një shtatëdhjetë copë (70)  
Mehdiu: po.  
Beha: një dhjetë copë (10) sa duhet të marr?  
Mehdiu: hajde këtu dhe bëj çfarë të duash.....  
Beha: jo, jo, jo, unë ia lë paratë këtij djalit  
Mehdiu: hajde këtu se nuk ka problem  
Beha: sa duhet të lë (të jap)?  
Mehdiu: po, sa të duash, mos më bëj të flas, për hir të Zotit.

11 më 20 prill 2008 ai tentoi t'i shiste personit të quajtur "Ismet" 40 plumba të një kalibri të panjohur.

Integrali i telefonatës së interceptuar nga ora 11:30:35 deri në orën 11:31:37 pranuar nga telefoni celular i të pandehurit (044201844) nga personi që quhet Ismet nga Gremja, i cili ia kaloi telefonin një personi të panjohur (044299522) në lidhje me 40 plumbat:

PPM: këtu axhës i duhen një dzzet (40), S-S  
Mehdiu: unë po vij atje, dije që po vij atje  
PPM: në rregull  
Mehdiu: po vij atje tani  
PPM: në rregull.

12 më 2 maj 2008 ai tentoi t'i shiste 10 plumba një personi të panjohur.

Integrali i telefonatës së interceptuar nga ora 13:09:37 deri në orën 13:09:54 pranuar nga telefoni celular i të pandehurit (044201844) nga një person i panjohur (044201844) i referohet dhjetë (10) plumbave:

Mehdiu: ku është Pëparimi?

PPF: ai është këtu jashtë

Mehdiu: thuajti atij nja dhjetë (10) copë të shtatëve (7), leri t'i sjelli në Shitime, leri t'i sjelli në Shitime, nja dhjetë (10) copë të shtatëve.

PPF: në rregull.

13 më 22 maj 2008 ai tentoi t'i shiste një pistoletë të prodhimit Italian për çmimin 330 Euro një personi të panjohur.

Integrali i telefonatës së interceptuar në orën 17:32:11 pranuar nga telefoni celular i të pandehurit (044201844) nga një person i panjohur në lidhje me një pistoletë të prodhimit Italian për çmimin 330 Euro:

PPM: çfarë po bën....

Mehdiu: Jam këtu në Ferizaj bashkë me Feratin.

PPM: ti je në Ferizaj

Mehdiu: po jemi këtu në parkingun e personave të paafte.

PPM: në rregull, mund të vij më vonë, tani po shkoj deri në një vend, doja të kasha një nga ato llojet një nga ato italianet ti e di me B.

Mehdiu: po.

PPM: sa kushton një më e mira.

Mehdiu: nga më të mirat 300

PPM: në rregull, në rregull, pot a marr atë lloj malli ....

Mehdiu: shih se mos është fallico apo diçka tjetër.

PPM: jo, jo mos u bëj merak, por ai po thotë 350.

Mehdiu: sa

PPM: 350.

Mehdiu: 350 është shumë, është shumë.

PPM: e di mund ta marr për ty

Mehdiu: a është e re fringo apo jo.

PPM: jo, po, po është e re fringo, e re fringo

Mehdiu: rreth 300, mos u largo nga ai.

14 më 3 qershor 2008 ai tentoi t'i shiste 6 pistoletë personit të quajtur "Rifa".

Integrali i telefonatës së interceptuar në orën 14:50:32 pranuar nga telefoni celular i të pandehurit (044201844) nga personi i quajtur "Rifa" i referohet gjashtë pistoletave:

Mehdiu: ej dëgjo aty ku je ti

Rifa: këtu në dyqan në market

Mehdiu: të betohem që nuk janë më shumë se 6 a dëglove ...

Rifa: jo, jo kjo punë mbaroi

Mehdiu: t'i vonoj ato jo

Rifa: nuk mundem, nuk mundem

Mehdiu: 6 i mbaroj ato pas 1 ore, mund të t'i sjell

Rifa: në rregull u krye unë do të pres për ty në dyqan

15 më 29 qershor ai tentoi të blinte 20 pako me municione.

Integrati i telefonatës së interceptuar në orën 11:57:22 pranuar nga telefoni celular i të pandehurit (044201844) nga personi i quajtur “Arben” ka të bëjë me njëzetë pako municione:

Arbeni: çfarë të duhet dhe sat ë duhen për sonte për gjërat e tua

Mehdiu: po, shumë gjëra

Arbeni: sa do të marrësh më thuaj, sepse normalisht janë shumë, por sa do marrësh ti

Mehdiu: të betohem nja 20, 30, a 40.

Arbeni: eji dëgjo ato pakot i ke për 35

Mehdiu: po a

Arbeni: po, më thuaj sa do marrësh, nëse ke diçka për të më dhënë sonte

Mehdiu: po, por ku janë, ku janë

Arbeni: sonte, sonte

Mehdiu: në rregull atëherë sonte 20, 20 të betohem jo më shumë, por shumë e ke 35 Arben

Arbeni: 20 pako

Mehdiu: po.

Arbeni: dhe ato të mëdatë nuk i do

Mehdiu: jo por do shohim për të mëdatë Arben do shohim për të mëdatë

Arbeni: 20 dhe asgjë tjetër

Mehdiu: o jo, të betohem jo

Arbeni: në rregull, në rregull 20 i kam me siguri por ti ke gjëra

Arbeni: në rregull atëherë a mund të vij unë

Arbeni: sonte rreth orës 8 afati më i fundit

Mehdiu: në rregull u krye unë do të të informoj kur të jem atje më dëgjo

Arbeni: jo, jo ndoshta i sjell ato atje.

Përsa i përket deklaratave të të pandehurit në lidhje me interceptimet e telefonatave, Mehdi LIMANI ka tentuar të japë një shpjegim të ndryshëm të rezultateve të interceptimeve, duke vënë në pyetje faktin që ai nuk ka genë personi që ka përdorur telefonin e tij celular (044201844) kur janë kryer interceptimet e telefonatave të pranuar apo të bëra.

Ka disa pjesë të procesverbalit të seancës së mbajtur më 21 janar 2009:

**Prokurori Publik:** *A ka genë e mundur që dikush tjetër t'i ketë përdorur telefonat e tu?*

**Mehdi Limani:** *Po.*

**Prokurori Publik:** *Krish?*

**Mehdi Limani:** *Qëkur jam plagosur në vitin 1998, unë pi shumë dhe më ka ndodhur shpesh që t'i le telefonat e mi mbi tavolinë e të kthehem pas një ore e të shoh se nuk ka fare kredit.....(higet).....*

Këto janë pjesët përkatëse nga procesverbali i seancës së mbajtur më 22 janar 2009:

**Andrea Cruciani:** *Interceptimet e telefonatave që iu lexoi Prokurori, shumë prej tyre i referoheshin armëve dhe plumbave dhe disa prej tyre i referoheshin pseudonimit Gadafi. Si i shpjegoni ju këo bisada?*

**Mehdi Limani:** *Pas lëndimeve në luftë, unë punova në një shoqatë, dhe gjatë asaj kohe ne shkonim nëpër vendet e pasluftës. Ne kemi zhvilluar takime me ushtarë, të cilat kanë genë një aftë interesante. Shërbbimi ushtarak i ish-Jugosllavisë, unë e kam kryer atë në vitin*

1981 dhe kam punuar në një magazinë për armët, kështu që pak a shumë kam genë i njohur me armët, përsa i përket dëmeve te vogla; dhe në atë rast mua më kanë thirrur ushtarët që t' i rregulloja.

**Andrea Cruciani:** Ne po flasim për marsin deri në korrik të vitit 2008. A keni genë ende i përfshirë në këto kontakte me ushtrinë?

**Mehdi Limani:** Jo.

**Andrea Cruciani:** A mund të na shpjegoni, ju lutem, këto biseda në gjykatë.

**Mehdi Limani:** Siç e kam thënë edhe dje, unë kam kaluar shumë kohë në kafene duke pirë shumë, kështu që disa njerëz mund ta kenë përdorur telefonin tim.

**Andrea Cruciani:** Kur thoni që njerëz mund ta kenë përdorur telefonin tim, si mund të ndodhë që njerëzit të mund ta kenë përdorur telefonin tënd thuajse për çdo sekondë të ditës për një periudhë, të muajve nga mars deri në korrik të vitit 2008?

**Mehdi Limani:** Nuk jam i sigurt a e shpjegova këtë dje që ne kemi një kompani udhëimesh me autobus. Ne i transportojmë njerëzit me autobus nga Ferizaji në Shitnje dhe ka ndodhur shumë herë që unë ta kem harruar telefonin tim në autobus; këtë kompani e kemi pasur unë dhe vëllai im.

**Andrea Cruciani:** A po thoni që gjatë datave, më 5, 6, 7, 8, 10, 14, 15 e kështu me rradhë, në muajin mars, gjatë gjithë këtyre ditëve ti e ke harruar telefonin në autobus dhe se dikush tjetër i është përgjigjur këtyre telefonatave dhe i ka përdorur ato për të blerë apo për të shitur plumba?

**Mehdi Limani:** Mua nuk më kujtohet data e saktë por (Gjyqtari e ndërpret)

**Kryetari i Trupit Gjykuës:** Është e çuditshme, që ti ta harrosh telefonin gjithë kohën; e dikush fillon të blejë e të shesë plumba?

**Mehdi Limani:** Unë nuk besoj që dikush flet për këto gjëra gjithë kohës nga telefoni im, por interceptimet nuk janë të sakta, sepse ato thonë që unë transportoj plumba dhe armë, por kur më ka ndaluar policia dhe më ka kontrolluar mua dhe automjetin tim, ata nuk gjeten asgjë.

**Andrea Cruciani:** Ju po na thoni ne që e ke harruar telefonin në autobus. Si e more telefonin?

**Mehdi Limani:** Kur shkojmë në Ferizaj, në stacionin e autobusevë, ne kemi pushime dhe e parkojmë autobusin në parking e pastaj shkojmë e hamë drekë dhe pimë çaj, kështu që mund të ndodhë.

**Andrea Cruciani:** Si e more telefonin?

**Mehdi Limani:** Kur vjen koha për t' i kthyer, nga Ferizaji në Shitnje, katër herë në ditë. Kështu që, atëherë unë e marr telefonin.

**Andrea Cruciani:** Disa nga telefonatat që kemi interceptuar dhe që i referohen armëve dhe plumbave, janë regjistruar vonë në mbreñje mes orës 1900 dhe 2200?

**Mehdi Limani:** Unë thashë, që pasdite kam ndenjtur shumë nëpër kafene.

**Andrea Cruciani:** Cfarë ndodh në këto kafene?

**Mehdi Limani:** Ne rrimë dhe pimë me shokë, shesim makina, dru, pjesë makinash, etj.

**Andrea Cruciani:** Unë po i referohem telefonatave që janë bërë vonë në mbreñje. Si i shpjegoni ato?

**Mehdi Limani:** Pas luftës, ne e thërrisim njëri-tjetrin me pseudonime, të tilla si 'ku je ti Kallash', 'ku je ti Gadaf' e kështu me rradhë.....(Niget).....

**Bahir Troshupa:** A po i shet dru ndërtuesve? Si janë përmasat, a janë ato të holla, të gjata?

**Kryetari i Trupit Gjykuës: Më duhet t'iu ndaloj këtu. A e masni drurin me kalibër?**

**Mehdi Limani: Po, kur talleshim.**

Trupi Gjykuës i konsideron deklaratat e theksuara të të pandehurit tejte të pabesueshme. I pandehuri është përjekur ta bindë këtë Trup Gjykuës në lidhje me argumentet shfaqësuese, të cilat janë sajuar gartësisht nga i pandehuri. Mehdi LIMANI i referohet në deklaratat e tij rrethanave të ndryshme dhe kontradiktore për të justifikuar interceptimin e telefonatave, duke kaluar nga përtshirja e tij në konfliktin e armatosur në Bosnjë tek fakti që ai është i dhënë pas alkoholit, në përdorimin e autobosit publik, prezencës së tij në nëpër kafene në mbrenje, tek përdorimi i masës së "kalibrir" për të matur drurët që shet.

Trupi Gjykuës nuk është i bindur për asnjë nga argumentet të cilave u referohet i pandehuri.

Është absolutisht e pallogjishme dhe e papranueshme që i pandehuri ta ketë harruar telefonin e tij celular në një autobus publik, dhe se çdo herë dikush e ka përdorur atë telefon të harruar celular me qëllim që të trafikojë armë.

Këto deklaratat bëhen edhe më të pabesueshme, nëse tregohet vëmendje ndaj rrethanave në të cilat personi që mund ta ketë përdorur telefonin celular të të pandehurit, të jetë marrë në telefon nga një person tjetër me pseudonimin Gadafi dhe ai të jetë përgjigjur duke thënë se ishte personi me atë emër (Gadafi).

Për më tepër, i pandehuri ka deklaruar gjithashtu se jo vetëm që ai vazhdon ta harronte telefonin në autobus, por se edhe gjatë mbrenjeve, kur janë bërë shumica e interceptimeve të telefonatave, ai ka qenë ulur në një kafene, ku celulari i tij është marrë nga persona të panjohur dhe është përdorur për qëllimet e mësipërme të paljgjshme. Madje edhe këto rrethana nuk janë fare të pranueshme.

Nuk është e drejtë të shtjellohet më shumë në lidhje me deklaratat e pabesueshme dhe të papranueshme të të pandehurit. Versionet gartësisht të pallogjishme dhe të papranueshme të të pandehurit në lidhje me ngjarjet, as që mbështeten nga ndonjë provë të vetme. Në të kundërt, ato janë në kundërtënie me rezultatet e interceptimeve të telefonatave dhe me të gjitha provat e tjera materiale të mbledhura gjatë hetimit dhe të paraqitura në gjykatë.

### **2.1.2. Akuzat II e aktakuzës.**

Përsa i përket akuzës II të aktakuzës, i pandehuri Mehdi LIMANI gjatë marrjes në pyetje në shryimin kryesor ka pranuar se më datën 29 korrik 2008 ai po shkonte të shiste njëzetë (20) plumba në stacionin e benzinës "Migroll Petroll Station" përgjatë rrugës Prishtinë-Ferizaj, por ai u arrestua pak përpara.

Ky është pasazhi përkatës nga procesverbali i seancës së mbajtur më datën 22 janar 2009:

**Azem Vllasi: Ju keni shpjeguar për Ramadanin tek ky stacion benzine, pasi keni pyetur për një sasi të caktuar plumbash të cilat ju i sollët dhe ia dhatë atij falas. A mund të na thoni se çfarë ndodhi me këto plumba? A ia dhe ato Ramadanit, apo i ka marrë policia, apo çfarë ndodhi me to?**

**Mehdi Limani: Së pari, dua të them që emri i këtij personi nuk është Ramadan, emri i tij është Rahman. Është e vërtetë që ia dhashë 20 plumba Rahmani. Ai m'i kërkoi se do**

*shkonte në një dasëm. Unë ia dhashë plumbat Rahmani, në dorë dhe doja të shkoja në Ferizaj. Motorri im ishte i ndezur, një automjet ndaloi aty pranë; nuk më kujtohet ngjyra e keik automjeti. Dy persona me armë dolën nga makina dhe thanë, dil nga makina, ngri duart dhe je i arrestuar.*

### **2.1.3. Kualifikimi ligjor në lidhje me Akuzën I, Paragrafin 1, dhe Akuzën II të aktakuzës.**

Lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale, akuzën në pjesën I, Paragrafi 1), dhe II të aktakuzës që i referohen “Furnizimit, Transportimit, Prodhimit, Shkëmbimit dhe Shitjes së Paautorizuar të Armëve”, në kundërshtim me Nenin 327, Paragrafët 1 dhe 2, të KPPPK. Pavarësisht, me qëllim që të arrihet kryerja e plotë e veprës penale në fjalë, është e nevojshme të provohet që shkëmbimi apo shitja e armëve të ketë ndodhur në mënyrë të efektshme. Në procedurën penale në fjalë, në lidhje me argumentet e përmendura, ajo që është provuar është se i pandehuri ka ndërmarrë veprime të menjëhershme të qëllimshme drejt kryerjes së veprës penale në fjalë, duke kontaktuar (ose duke u kontaktuar me/nga) persona të panjohur e duke diskutuar të gjitha detajet përkatëse të shkëmbimeve ose shitjeve (llojet e armëve dhe municioneve, cilësinë, çmimin, datën dhe vendin e dorëzimit). Në të kundërtën, Prokurori Publik, ka dëshuar së demonstruari se shkëmbimet apo shitjet e diskutuara në fakt kanë ndodhur, megjë asnjë hap hetimor nuk është ndërmarrë në lidhje me këtë qëllim. Për shembull, nuk është regjistruar asnjë veprimtari e masave të fshehta fotografike apo regjistrimeve të fshehta me videokamera në lidhje me transaksionet e paligjshme të armëve dhe municioneve në fjalë dhe madje nuk është kryer as ndonjë blerje e stimuluar e sendeve në fjalë.

Për shkak të arsyeve të sipërpërmendura dhe kualifikimit të saktë ligjor të veprave penale të kryera nga i pandehuri Mehdi LIMANI, kjo veprë penale është Tentativa e Furnizimit, Transportimit, Prodhimit, Shkëmbimit dhe Shitjes së Paautorizuar të Armëve, në kundërshtim me Nenet 327 (1) dhe 20 të KPPPK.

### **2.1.4. Lirimi nga disa incidente të referuara na Akuzën I, Paragrafët 1 dhe 2, të aktakuzës.**

Nga ana tjetër, i pandehuri do të lirohet në lidhje me incidentet e mbetura të përmendura në akuzën I, Paragrafët 1 dhe 2, të aktakuzës, megjë ato nuk janë mbështetur në mënyrën e duhur me prova të mjaftueshme.

Në veçanti, në lidhje me incidentet e mëposhtme, Prokurori Publik i ka parqajtur Gjykatës vetëm një përmbledhje të telefonatave të interceptuara, pa integralët e transkriptimeve të tyre, kështu që nuk është e mundur nga ana e Trupit Gjykses të vlerësojë nëse referencat që i bëhen përmbledhjeve në fjalë në lidhje me armët dhe municionet, janë qartësuar plotësisht në biseda apo nëse ato janë rezultat i ndonjë vlerësimi të bërë nga oficerët e policisë të ngarkuar me detyrën e hartimit të përmbledhjeve:

- 1 Më 16/04/2008 ai i ka shitur një pistoletë të tipit “Beretta”, për çmimin 300 € personit të quajtur Naser N, me numër telefoni celular 044 664 800;
- 2 Më 19/ 05/ 2008 ai ka shitur një pako me plumba për pistoletën “TT”;
- 3 Më 22/ 05/ 2008 ai ka shitur një pako me barut për armën M-48 “djallit të Eminit”;

- 4 Më 22/ 05/ 2008 ai i ka shitur 50 plumba të armës M-48 një personi të panjohur;
- 5 Më 23/ 05/ 2008 ai i ka shitur një personi të panjohur një armë pa një çmim të caktuar;
- 6 Më 25/ 05/ 2008 ai i ka shitur një sasi plumbash, për çmimin prej 50 €, Kasim N.;
- 7 Më 08/ 06/ 2008 ai i ka shitur një personi të panjohur 16 bullets;
- 8 Më 08/ 06/ 2008 ai i ka shitur 40 plumba të pistoletës “TT”, personit të quajtur Agim N.;
- 9 Më 21/ 06/ 2008 ai i ka shitur 20 plumba të pistoletës “TT”, personit të quajtur Rahman N.;
- 10 Më 23/ 06/ 2008 ai i ka shitur një pistoletë, për çmimin 300 €, një personi të panjohur me pseudonimin “Ceni”;

I pandehuri do të lirohet gjithashtu edhe për incidentet e mëposhtme, meqë bisedat e raportuara të interceptuara dhe integralt e tyre përmbajnë një gjuhë të koduar, me referenca të thjeshta ndaj numrave apo çmimeve, dhe Trupi Gjykses nuk mund të bindej përtej dyshimit të arsyeshëm në lidhje me to, pra që referencat në fjalë, kishin lidhje me armët dhe municionet ose në të kundërtën me transaksione të tjera të ligjshme të mallrave:

- 11 Më 05/ 03/ 2008 ai i ka shitur një personi të panjohur një sasi plumbash për çmimin prej 100 €; në bisedë i bëhet referencë në gjuhë të koduar “çelësave”, “zogjive” dhe “pulave” dhe çmimit prej 100 Euro;
- 12 Më 05/ 03/ 2008 ai i ka shitur 30 plumba Shaban Bujës; referenca e vetme i bëhet numrit 30;
- 13 Më 07/ 03/ 2008 ai i ka shitur disa armë dhe një sasi të panjohur municionesh Faton N nga fshati Dremnjak; nuk i bëhet referencë shtifës së armëve por “gjërave” që nuk janë në shtëpi;
- 14 Më 01/ 06/ 2008 ai i ka shitur një personi të panjohur 25 plumba pistoletë; ekziston një integral i bisedës në të cilën Mehdiu pyetet për 25 plumba dhe ai përgjigjet që nuk i ka ato:

PPM: Ej, nja 20 copë nuk i ke, nga ato të voglat:  
Mehdiu: jo të betohem.

- 15 Më 15/ 06/ 2008 ai i ka shitur një personi të panjohur dy pistoletë “TT”, ekziston një integral i vogël i një pjese bisede, e cila i referohet atyre “të zezave”, por nuk është e qartë saktësisht se kujt i referohet.

### ***2.1.5. Lirimi nga Akuzat III e aktakuzës.***

I pandehuri do të lirohet gjithashtu edhe në lidhje me akuzën III të aktakuzës për “Furnizimin, Transportimin, Prodhimin, Shkëmbimin dhe Shitjen e Paautorizuar të Armëve”, në kundërshtim me Nenin 327 (1) të KPPK. Aktakuza lexon: “Më 27/07/2008 i pandehuri Rammush KUTLESHI ka transportuar pa autorizim 10 pako me plumba të kalibrit 9mm, 10 pako me plumba të kalibrit 7mm, 5 pako me plumba të kalibrit 6mm, nga shtëpia e tij që gjendet në fshatin Dumosh, Komuna e Podujevës, në një vend në

Pristinë, dhe pastaj ai ia ka shitur ato pa autorizim të pandehuri Mehdi LIMANI. Pastaj, ky i fundit, pasi i ka siguruar sendet në fjalë, të nesërmen, më 28/07/2008, si shkëmbim, i ka dhënë 1.150 € Bujar N, një punonjësi të magazinës “Te Bashkimi” pranë “Hib Petrol”.

Në dosjen e gjykatës, përveç konfiskimit të shumës së parave prej € 1.150,00 (një mijë e njëqind e pesëdhjetë) nga shtëpia e Ramush KUTLESHTIT, nuk ekziston asnjë provë tjetër në lidhje me këtë incident. Edhe në lidhje me sasinë e përmendur të parave, nuk ka prova që këto para përfaqësojnë çmimin për shitjen e municioneve. Dhe as Prokurori Publik gjatë shqyrtimit kryesor nuk ka mbështetur këtë akuzë të aktakuzës me ndonjë shpjegim apo provë tjetër, kështu që nuk janë demonstruar në asnjë mënyrë rrethanat në lidhje me këtë incident ashtu siç janë përshkruar ato në aktakuzë.

Si pasojë e mungesës së plotë të provave të përfshijes së Mehdi LIMANIT në transportimin dhe shitjen e municioneve në fjalë, i pandehuri do të lirohet nga kjo akuzë e aktakuzës.

Duke u bazuar në argumentet e ilustruara, trupi gjykses arrin në përfundimin siç është specifikuar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

## **2.2. “Pronësia, Kontrolli, Posedimi apo Përdorimi i Paautorizuar i Armëve” në kundërshtim me Nenin 328 (2) dhe (3) të KPPK, siç i referohet Akuzës I, Paragrafi 2), i aktakuzës.**

Në lidhje me akuzën e “Pronësise, Kontrollit, Posedimit apo Përdorimit të Paautorizuar të Armëve”, në kundërshtim me Nenin 328 (2) dhe (3) të KPPK, i pandehuri Mehdi LIMANI e ka deklaruar veten fajtor për akuzën I, Paragrafi 2), të aktakuzës, ku sipas tij, “deri më 29/07/2008 ai ka mbajtur pa leje të vlefshme nja sasi të madhe armësh, duke mbajtur kështu në shtëpinë e tij një pistoletë të tipit “Zastava”, me numër serie nr. 92431, ndërsa në garazh-in e tij ai ka mbajtur një sasi të përgjithshme prej 1.423 plumbash të kalibrit 7.62mm; plumba të kalibrit 7.62 mm me mbishkrimin II 65; plumba me gaz; të kalibrit 7.62mm; të kalibrit 9mm; të kalibrit 7.62 mm, të kalibrit 7/62mm me mbishkrimin II 64 dhe të kalibrit 6.35mm.”

Armët dhe municionet e kalibrave të ndryshëm u gjetën në premissat e shtëpisë së tij pas urdhrit të bastisjes dhe konfiskimit nga ana e policisë më datën 30 korrik 2008.

Më poshtë gjendet një pasazh nga raporti i hartuar më 30 korrik 2008 nga oficerja e policisë Shqipe Ahmeti #6488 e Njësise së Krimit të Ferizajit:

*“Ne u informuam nga Rreshteri Driton Vrajolli se gjatë bastisjes së shtëpisë së të dyshuarit Mehdi Limani u gjend një armë dhe një sasi municioneesh. Municionet u gjendën në garazh, i cili ndodhej prapa shtëpisë, ndërsa arma u gjend në shtëpinë e të dyshuarit.*

### **1. Teknikat e vendit të ngjarjes**

*Fotografimi i vendit të ngjarjes është bërë me një kamera dixhitale nga tri distanca: larg, mes dhe afër. Pasi u municionet u hoqën nga qesia ku ishin paketuar, ato u rradhitën, u numëruan dhe u evidentuan me numrat e mëposhtëm:*

*I-sasia e përgjithshme e municioneve që është evidentuar*  
*1A- 285 copë plumba të kalibrit 7,62, një karikator dhe pesë mbajtëse plumbash që u evidentuan*  
*1B- 165 plumba të kalibrit 7,62 me mbishkrimin II 65 dhe 3 karikatorë që u evidentuan*  
*1C- 16 plumba me gaz që u evidentuan*  
*1D- 7 plumba të kalibrave të ndryshëm që u evidentuan*  
*1E- 315 plumba të kalibrit 7,62 që u evidentuan*  
*1F- 302 plumba të kalibrit 9mm dhe 100 plumba të kalibrit 7,62 që u evidentuan*  
*G- 63 plumba të kalibrit 7,62 me mbishkrimin II 64 që u evidentuan*  
*1H- 184 plumba të kalibrit 6,35mm që u evidentuan*

*2- Arma me mbishkrimin 9243J që u evidentua*

*[3] Provat janë pakëtuar pasi janë evidentuar dhe të njëjtit janë konfiskuar nga Njësia DKKO e cila është përgjegjëse për rastin. ”*

Rrethanat e kësaj ngjarjeje janë shpjeguar gjithashtu edhe nga i pandehuri gjatë marrjes së tij në pyetje. Këto janë pasazhet më të rëndësishme nga procesverbali i seancës së zhvilluar më 21 janar 2009:

**Prokurori Publik:** *A keni dijeni në lidhje me faktin se në shtëpinë tuaj janë gjetur disa municione?*

**Mehdi Limani:** *Po.*

**Prokurori Publik:** *Kush të tregoi?*

**Mehdi Limani:** *Përsa i përket pistoletës, ajo është e imja; ishte një pistoletë e vjetër, dhe me sa më kujtohet ishte e prodhimit gjerman. Pas luftës gjeta një sasi municionesh. Nuk e dija me saktësi se sa kisha. Pas luftës gjeta një policisë dhe ushtrisë serbe në vitin 1999, ne u kthyem në shtëpi dhe unë gjeta sasinë e municioneve; të llojeve të ndryshme. E fshëha atë prej fëmijëve të mi. Më vjen keq që e kam gjetur dhe që nuk e kam informuar policinë për to. Nuk e di me saktësi se sa kam gjetur. Kur policia ka bërë bastisjen unë nuk kam qenë në shtëpi.*

Në këtë mënyrë, elementi material (*actus rei*) sigurohet me anë të rrethanës faktike që sasia e përshtuar e armëve dhe municioneve të kalibrave të ndryshëm janë gjetur në lokalet e shtëpisë së tij, pas kryerjes së një bastisjeje dhe konfiskimit të ligjshëm të kryer nga policia, më datën 30 korrik 2008, si edhe me anë të dëshmisë së të pandehurit.

Elementi psikologjik (*mens rea*) demonstronhet me anë të njohurisë që të ruhej materiali i përmendur pa ndonjë leje të vlefshme. Kjo njihet nga i pandehuri, megjë ai e deklaroi veten fajtor në lidhje me këtë akuzë të veçantë të aktakuzës dhe ai e ka konfirmuar posedimin e paautorizuar gjatë marrjes në pyetje në gjykimin kryesor.

Sa për kualifikimin ligjor të veprës penale, pavarësisht nga fakti se terminologjia e përdorur në këtë aktakuzë nuk është e saktë, megjë ajo i referohet “Mbajtjes së Paautorizuar të Armëve”, referenca e saktë i bëhet Nenit 328, Paragrafët (2) dhe (3) të

KPPK, i cili e penalizon “Pronësinë, Kontrollin, Posedimin apo Përdorimin e Paautorizuar të Armëve”.

Sendet që u gjendën në lokalet e të pandehurit sigurisht klasifikohen si armë. Me të vërtetë, sipas Nenit 107, Paragrafi 28), të KPPK, termi “armë” do të thotë “një instrument i dizajnuar, i përdorur apo i përdorshëm për të shkaktuar dëmtim trupor. Kjo do të përfshijë, ndër të tjera, të gjitha llojet e municionit, hargjet dhe shigjetat, sprejin, gazin CS, armët me qortfshkë, armët imituese, armët për alivanosje, taserët, (mjartet që punojnë në bazë të elektroskokut) dhe të gjitha llojet e armëve të paraqitura në Aneksin A të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/7 mbi Autorizimin e Posedimit të Armëve në Kosovë apo armëve të ngjashme.”

Për më tepër, nuk ka asnjë dyshim se sasia e armëve të përfshira do të konsiderohet si “e madhe”, në përputhje me Nenin 327, Paragrafin 2, të KPPPK, megjë sasia e materialeve në fjalë është mjaft e madhe.

### **3. Përgjegjësia penale e Skënder MAHMUTIT.**

I pandehuri Skënder MAHMUTI është akuzuar nga Prokurori Publik për “Furnizimin, Transportimin, Prodhimin, Shkëmbimin apo Shtifjen e Paautorizuar të Armëve”, në kundërshtim me Nenin 327 (1) të KPPK, sepse më 29 korrik 2008 ai u largua nga shtëpia e tij në fshatin Godancë, Komuna e Shtimjes dhe ka shkuar tek “Stacioni i benzinës Migroll Petroll që gjendet për gjatë rrugës Prishtina-Ferizaj, dhe në orën 16:00, së bashku me Ramadan N, ka kontaktuar me Mehdi LIMANIN, të cilin e kishte thirrur më herët Ramadan N, për të transportuar pa autorizim 37 plumba të kalibrit 7.65 mm në atë vend, megjë ata kishin marrë një urdhër (për blerje) nga Liridon GASHI nga fshati Godancë, Komuna e Shtimjes, për t’i transportuar ato plumba më pas pa autorizim, në shtëpinë e tij në fshatin Godancë me automjetin “Jeep-Opel Frontera”.

Përsa i përket akuzës II të aktakuzës, për të cilën i pandehuri është deklaruar i pajafajshëm në gjykatë, Ky Trup Gjykses është i mendimit se përgjegjësia penale është provuar, por vetëm në formën e “tentativës”, në bazë të Nenit 20 të KPPK.

Në veçanti, deklaratat e të pandehurit dhe provat e tjera të paraqitura gjatë zhvillimit të gjykitimit kryesor, kanë demonstruar se Skënder MAHMUTI më 29 korrik 2008 është larguar nga shtëpia e tij në fshatin Godancë, Komuna e Shtimjes dhe ka shkuar tek stacioni i benzinës “Migroll Petroll” që gjendet për gjatë rrugës Prishtina-Ferizaj, me qëllim që të blinte 20 plumba nga Mehdi LIMANI. Përpara se ai faktikisht t’i merrte plumbat dhe të paguante çmimin për blerjen e paligjshme, ai u arrestua nga policia.

Ky është një pasazh i marrë nga procesverballi i seancës së mbajtur më datën 22 janar 2009:

**Prokurori Publik:** *A të kujtohet se për çfarë keni biseduar me Rahmanin?*

**Skënder Mahmuti:** *Po.*

**Prokurori Publik:** *Cila ishte tema e diskutimit tuaj?*

**Skënder Mahmuti:** Pasi shkova për të mbushur makinën me benzinë, dhe përpara, mua më mori në telefon një shoku im, ai po punonte diku tjetër e më tha: A mund të gjesësh për mua diku 20 plumba. Pasi shkova tek stacioni i benzines, unë e pyeta Rahmamin: A njeh ndonjë njeri që mund t'i gjejë ato plumba për mua....(hiqet)....

**Kryetari i Trupit Gjykuës:** Çfarë ndodhi?

**Skënder Mahmuti:** Unë isha në restorant duke pirë kafje, kur u largova nga restoranti, erdhi makina e policisë dhe polici na arrestoi.

**Kryetari i Trupit Gjykuës:** Të arrestoi ty dhe kë tjetër?

**Skënder Mahmuti:** Personin që po voziste Fronterën.

**Kryetari i Trupit Gjykuës:** Përse po prisnit në restorant?

**Skënder Mahmuti:** Unë nuk po prisja për njeri, unë vetëm po pija kafje.

**Kryetari i Trupit Gjykuës:** Por ju thate që kishi porositur 20 plumba dhe Rahmani do t'i merrte ato për ty dhe pasta jai thirrri në telefon një person të quajtur Gadaf. Pra, pyetja ime është, a pritët për ato 20 plumba?

**Skënder Mahmuti:** Unë bëra porosinë, por nuk po prisja për plumbat....(hiqet)....

**Prokurori Publik:** A keni parë plumba në atë vend në atë kohë?

**Skënder Mahmuti:** Unë pashë vetëm policinë kur erdhen për të na arrestuar.

**Prokurori Publik:** Ku i pe plumbat?

**Skënder Mahmuti:** Unë i pashë ato në dysheme.

**Kryetari i Trupit Gjykuës:** Cilën dysheme?

**Skënder Mahmuti:** Përpara stacionit të benzines....(hiqet)....

**Kryetari i Trupit Gjykuës:** A nuk e njohë Mehdi Limarin nga ky incident?

**Skënder Mahmuti:** Po.

**Kryetari i Trupit Gjykuës:** A e pe atë duke vozitur makinën Opel Frontera?

**Skënder Mahmuti:** Po....(hiqet)....

**Andrea Cruciani:** Në lidhje me këto 20 plumba, a i dhe ndokujt ndonjë sasi parash?

**Skënder Mahmuti:** Jo, nuk i kam dhënë.

**Sylejman Nuredini:** Ju thate që plumbat ishin një porosi e bërë nga Liridon Gashi. A e njihnit atë më parë?

**Skënder Mahmuti:** Po, ai është një shoku im.

Veprat e kryera nga i pandehuri nuk i përmbushin kërkesat e kryerjes së veprës penale të “Furnizimit, Transportimit, Prodimit, Shkëmbimit apo Shitjes së Paautorizuar të Armëve”, sipas Nenit 327 (1) të KPPK, meqë veprimet e kryera nga i pandehuri nuk e kanë arritur kurrë fazën e shkëmbimit material të plumbave me çmimin. Pavarësisht nga kjo, përgjegjësia penale e të pandehurit ende ekziston si një “tentativë” për të kryer veprën penale në fjalë, sepse veprimet për të rënë dakort me Rahmamin për blerjen e 20 plumbave dhe vullneti i tij për ta përfunduar transaksionin e paligjshëm bien në dispozitat e Nenit 20 të KPPK, i cili ndëshkon këdo “që në mënyrë të qëllimshme ndërmerr ndonjë veprim të drejtpërdrejtë drejt kryerjes së një vepre penale dhe veprimi nuk është përfunduar apo elementet e veprës së qëllimshme nuk përmbushen.”

#### **4. Përgjegjësia penale e Ramush KUTLESHTIT.**

**4.1. Lirimi për "Furnizimin, Transportimin, Prodhimin, Shkëmbimin apo Shitjen e Paautorizuar të Armëve", sipas Nenit 327 (1) të KPPK, siç i referohet në Akuzën III të aktakuzës.**

Sa për akuzën për "Furnizimin, Transportimin, Prodhimin, Shkëmbimin apo Shitjen e Paautorizuar të Armëve", në kundërshtim me Nenin 327 (1) të KPPK, akuza III e aktakuzës lexon si më poshtë vijon: "*Më 27/07/2008 i pandehuri Ramush KUTLESHI ka transportuar pa autorizim 10 pako me plumba të kalibrit 9mm, 10 pako me plumba të kalibrit 7mm, 5 pako me plumba të kalibrit 6mm nga shtëpia e tij që gjendet në fshatin Dumosh, Komuna e Podujevës, në një vend në Prishtinë, dhe më pas ai ia ka shitur ato pa autorizim të pandehurit Mehmet LIMANI. Më pas, ky i fundit, pasi i ka marrë sendet në fjalë, të nesërmen, më 28/07/2008, si shkëmbim i ka dhënë 1.150 € Bujar N, një punëtorë të magazinës "Te Bashkimi" pranë "Hib Petrol".*

Në dosjen e gjykatës, përveç konfiskimit të sasisë së parave prej € 1.150,00 (një mijë e njëqind e pesëdhjetë) nga lokalet e shtëpisë së të pandehurit, nuk ekziston asnjë provë tjetër në lidhje me këtë incident. Edhe në lidhje me sasinë e përmendur të parave, nuk ka asnjë provë që këto para përfaqësojnë çmimin për shitjen e municioneve. As Prokurori Publik, gjatë zhvillimit të gjyqimit kryesor, nuk e ka mbështetur më tej këtë akuzë të aktakuzës me anë të sigurimit të shpjegimeve apo pjesëve të provave, kështu që në asnjë mënyrë nuk janë demonstruar rrethanat e këtij incidenti siç përshkruhet ai në aktakuzë.

Si pasojë e mungesës së plotë të provave në lidhje me përfshirjen e Ramush KUTLESHIT në transportimin dhe shitjen e municioneve në fjalë, i pandehuri do të lirohet nga kjo akuzë e aktakuzës.

**4.2. "Pronësia, Kontrolli, Posedimi apo Përdorimi i Paautorizuar i Armëve" në kundërshtim me Nenin 328 (2) dhe (3) të KPPK, siç i referohet në Akuzën IV të aktakuzës.**

Përsa i përket akuzës së "Pronësisë, Kontrollit, Posedimit apo Përdorimit të Paautorizuar të Armëve" në kundërshtim me Nenin 328 (2) dhe (3) të KPPK, i pandehuri Ramush KUTLESHI e ka deklaruar veten fajtor në lidhje me akuzën IV të aktakuzës, megjë më 30 korrik 2008 në shtëpinë e tij në fshatin Dumosh ai mbante armët dhe municionet e mëposhtme: një pistoletë "Beretta"; një postoletë "Zastava", me numër serie nr. ET834037; 8526 (tetë mijë e pesëqind e njëzetë e gjashtë) plumba të kalibrave të ndryshëm.

Më 30 korrik 2008 është ekzekutuar një bastisje nga Policia e Kosovës – Zyra e Kriminalistikës, në lokalet që gjenden në fshatin Dumosh/Komuna e Podujevës. Operacionet janë mbikëqyrur nga oficeri i policisë Haki BERISHA, i cili është marrë në pyetje në gjykatë më datën 20 janar 2009, e që ka konfirmuar përmbajtjen e raportit.

Ky është nja pasazh i marrë nga raporti i policisë së datës 30 korrik 2008:

“Pastaj ne vazhduam me dokumentin, ku në pjesën e shtojcës, tek njëra nga dhomat e përdorura, që përdorej edhe si kasolle druri. Gjatë bastisjes atje ne gjetëm një sasi të municioneve të ndryshme. Ajo u nda në grupe, prandaj edhe u regjistrua me numra, nga Nr. 1 deri në Nr. 7. Në këtë rast janë bërë edhe fotografi të provave të këtyre dokumenteve. Në oborrin e kësaj shtëpie, poshtë jastekut të djepit, u gjend një pistoletë e kalibrit 6.35 mm, Bereta mod. 950 B dhe një karikator me tetë (8) plumba, të kalibrit 6.35. Makina Golf II me ngjyrë të bardhë, numri i largës 101 - KS - 822 është regjistruar me numrin 9. Në këtë mëtinë, pas karrikes së shoferit, nën tapet, u gjenden dhe u regjistruan provat e mëposhtme: plumba të kalibrit 7.62X25 mm. Njëzetë (20X70 copë) kati. Gjithashtu edhe një pistoletë “ZASTAVA”, me numrin serial nr. ET834037 me dy plumba .....(nigel).....Gjatë numërimit të plumbave doli edhe numri përfundimtar i sasisë së armëve dhe municioneve. Një (1) pushkë gjuetie, e kalibrit 12 mm. Dy (2) pistoletë, të kalibrit 6.35 mm. 8526 (tetë mijë e pesëqind e njëzetë e gjashtë plumba të kalibrave të ndryshëm).”

I pandehuri Ramush KUTLESHI e ka deklaruar veten fajtor edhe për këtë akuzë të aktakuzës, dhe ka pranuar të ketë qenë në pronësi të arsenalit të pëshkruar në premisat e shtëpisë së tij.

Këto janë pasazhet më domethënëse të deklaratës së të pandehurit nga procesverbali i seancës së mbajtur më 22 janar 2009:

**Hamdi Podvorica:** *Ku i gjeti z. Ramush këto armë?*

**Ramush Kutleshi:** *Ato municione dhe ato armë i kam gjetur kur punoja në fushë pranë aeroportit, ku kam qenë duke punuar. Ka pasur disa punëtorë që punonin në rrugë dhe ndërsa ata po punonin, në fund të fushës ka pasur edhe disa plehra. Makinat e plehrave i kanë marrë ato plehra, dhe unë kam punuar në fushë në të njëjtin vend. Unë pashe një tub të madh sa dora ime, supozova se ishte nga ato ta stacionit elektrik, dhe ndalova për të parë se çfarë kishte në të. Ndërkohë që ajo makinë punonte atje, unë shkova të shihja se çfarë kishte në tub. Edhe përreth tubit kishte plehra. Unë vura re dy plumba dhe aty pranë vura re një kanace të madhe që ishte dëmtuar nga makineria e ndërimit, dhe pastaj e lashë atë tub prapa dhe vazhdova punën dhe pastaj shkova drejtë e në shtëpi. Pastaj unë u ktheva me makinën time; i mora ato dhe i vendosa në garazhin e shtëpisë sime. I lashë dhe i mbulova me një leckë. Në atë garazh kishte gjymyr dhe dru.*

**Hamdi Podvorica:** *Pse nuk i le aty ku i gjetë; pse i more në shtëpi?*

**Ramush Kutleshi:** *Megë ato gjendeshin përreth unë i mora që t'i parandaloja fëmijët që t'i gjenin, megë fëmijët kalonin shumë kohë në fushë me bagëtinë.....(nigel)....*

**Ramush Kutleshi:** *Po, jam fajtor vetëm për municionet e gjetura në shtëpinë time.*

**Kryetari i Trupit Gjyqes:** *Por këtu thuhet që ka qenë një pistoletë Beretta dhe një pistoletë Zastava; a u gjetën ato në shtëpinë tuaj?*

**Ramush Kutleshi:** *Po.*

**Kryetari i Trupit Gjyqes:** *Pra, janë armë dhe municione?*

**Ramush Kutleshi:** *Po, të gjitha armët që u gjenden nga policia unë i kisha gjetur në fushë siç e thashë më parë....(nigel)....*

**Kryetari i Trupit Gjyqes:** *A i njeh armët atje?*

**Ramush Kutleshi:** *E di që kanë genë dy pistoletat, por asnjëherë nuk e studiovat municionin në detaje; madje edhe pas 40 minutash pasi i kisha hedhur ato në garazh. Kryetari i Trupit Gjyqësor: A po thoni që ju i gjetëi ato të njëjtën ditë që erdhi e ju arrestoi policia?*

**Ramush Kutleshi:** *Po, në të njëjtën ditë.*

**Andrea Cruciani:** *Ju mund të shihni në fotografitë që disa nga plumbat ishin vendosur në kuti të kuge; a e bërë këtë në të njëjtën ditë?*

**Ramush Kutleshi:** *Jo, nuk e kam bërë. Mënyra se si i gjeta ato, unë thjeshtë i mora ato dhe i hodha në garazh dhe policia erdhi edhe në më pak se 40 minuta.*

**Andrea Cruciani:** *A e gjetët një pjesë të këtij municioni ende në këto kuti?*

**Ramush Kutleshi:** *Po, unë nuk bëra asgjë me to. Unë i mora sigç i gjeta dhe nuk i vendosa nëpër ndonjë kuti, e me të vërtetë më vjen keq. Aty ku i gjeta armët dhe municionet, po të kishite pasur ndonjë minë atje, do ta kisha marrë edhe atë. Unë i mora ato në shtëpi dhe më vjen me të vërtetë keq që e kam bërë këtë. Kisha për qëllim që të lajmëroja policinë pas disa kohësh.*

Gjykata është e mendimit se, pavarësisht se rethanat në të cilat është gjetur arsenali në fjalë nga i pandehuri nuk janë qartësuar dhe se ka më shumë të ngjarë që i pandehuri t'i ketë poseduar municionet dhe armët e përshkruara me anë të ndonjë forme tjetër, ekziston një fakt i pakundërshtueshëm, i cili është prezent në këtë fazë, që arsenali në fjalë ka qenë në pronësi të tij dhe ai kishite njohuri të plota në lidhje me të.

Në këtë mënyrë, elementi material (*actus rei*) është provuar me anë të rethanës faktike që sasia e përshkruar e armëve dhe municioneve të kalibrave të ndryshëm janë gjetur në premisat e shtëpisë së tij, pas bastisjes dhe konfiskimit të ligjshëm nga ana e policisë që ka ndodhur më 30 korrik 2008.

Elementi psikologjik (*mens rea*) është demonstruar me anë të njohurisë për t'i mbajtur sendet e përmendura pa ndonjë leje të vlefshme. Kjo gjë pranohet nga i pandehuri meqë ai e ka deklaruar veten fajtor në lidhje me këtë akuzë të veçantë të aktakuzës dhe e ka konfirmuar mbajtjen e pautorizuar gjatë martes në pyetje në gjykimin kryesor.

Sa për kualifikimin ligjor të veprës penale, referenca e saktë i bëhet Nenit 328, Paragrafëve (2) dhe (3) të KPPK, në aktakuzë, i cili e penalizon "Pronësinë, Kontrollin, Posedimin apo Përdorimin e Pautorizuar të Armëve".

Sendet e gjetura në shtëpinë e të pandehurit sigurisht klasifikohen si armë. Me të vërtetë, në bazë të Nenit 107, Paragrafi 28), të KPPK, termi "armë" do të thotë "një instrument i dizajnuar, i përdorur apo i përdorshëm për të shkakuar dëmtim trupor. Kjo do të përfshijë, ndër të tjera, të gjitha llojet e municioni, hargjet dhe shigjetat, sprejin, gazin CS, armët me gorrfishkë, armët imituese, armët për alivanosje, taserët, (njetet që punojnë në bazë të elektroskokut) dhe të gjitha llojet e armëve të paraqitura në Aneksin A të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/7 mbi Autorizimin e Posedimit të Armëve në Kosovë apo armëve të ngjashme."

Për më tepër, nuk ka asnjë dyshim që sasia e armëve të përfshira do të konsiderohet si “e madhe”, në përputhje me Nenin 328, Paragrafin 3, të KPPPK, megjë sasia e materialit në fjalë është mjaft e lartë.

##### **5. Pozitia e Sami KUTLESHI.**

I pandehuri Sami KUTLESHI do të lirohet nga akuza IV e referuar në aktakuzë, për të cilën ai e ka deklaruar veten përsëri fajtor, atë të “Pronësisë, Kontrollit, Posedimit apo Përdorimit të Paautorizuar të Armëve”, në kundërshtim me Nenin 328 (2) dhe (3) të KPPK.

Gjykata mendon se nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur përfshirjen e drejtëpërdrejtë të Sami KUTLESHTIT në veprimtaritë penale, për të cilat është akuzuar gjithashtu edhe vëllai i tij. Në veçanti, pavarësisht se sasia e përshkruar e armëve dhe municioneve është konfiskuar në kasollen ngjitur me premisat e shtëpisë ku jeton gjithashtu edhe Sami KUTLESHI, nuk ka prova që ai faktikisht po i asgjësonte dhe posedonte këto armë dhe municione. Ka më shumë të ngjarë, që i pandehuri Sami KUTLESHI, i cili deklaroi në gjykatë se nuk kishte marrëdhënie të mira me vëllain e tij të madh, kishte njohuri se vëllai i tij i posedonte këto sende, por nuk ka qenë në pozitën që të reagoje ndaj një situatë të tillë. Deklaratat e bëra nga të dy, Sami dhe Ramush KUTLESHI sugjerojnë se vëllai më i vogël, Samiu ka qenë në një pozitë pasivë në lidhje me veprimtaritë e vëllait të tij të madh.

Ky është pasazhi përkatës nga procesverbali i seancës së mbajtur më 22 janar 2009:

**Prokurori Publik:** *A ju kujtohet kur erdhi policia të bastisë shtëpinë tuaj?*

**Sami Kutleshi:** *Po.*

**Prokurori Publik:** *Ku ishit ju?*

**Sami Kutleshi:** *Siç e kam thënë unë jam babai i tri femijëve, dhe jam i detyruar të ndihmoj gruan time kurdo që kam mundësi dhe në atë kohë gruaja ime më tha që të shkoja e të merrja ca dru. Kështu që, unë shkova në garazh ku ne mbajmë druë, dhe kur hapja derën pashë disa municione në garazh dhe vetëm i shtyva ato mënjane, dhe vazhdova të merrja druë. Unë u largova nga garazhi dhe shkova rreth 2 metra më tutje, dhe pashë një polic që po vinte drejtë meje, që më tha se isha i arrestuar. Unë vetëm hodha druë dhe ngrita duart lart.. (higet)....*

**Kryetari i Trupit Gjyqes:** *Si i ke marrëdhëniet me vëllanë?*

**Sami Kutleshi:** *Jo një marrëdhënie e mirë.*

**Kryetari i Trupit Gjyqes:** *A dëshiron ta shpjegosh atë?*

**Sami Kutleshi:** *Ne kemi pasur disa mosmarrëveshje familjare.*

**Kryetari i Trupit Gjyqes:** *Po ti ende jeton në të njëjtin vend?*

**Sami Kutleshi:** *Po, ne nuk kemi probleme serioze; ai sheh punën e tij dhe unë timen.*

Duke marrë në konsideratë deklaratat e të dy të pandehurve Ramush dhe Sami KUTLESHI, dhe argumentet e sipërpërmendura, kjo Gjykatë është e mendimit që nuk ka elementë të mjaftueshëm të deklarohet përtej ndonjë dyshimi të arsyeshëm përgjegjësia penale e të pandehurit Sami KUTLESHI për akuzën e treguar në aktakuzë.

## 6. Dënimi

### 6.1. Dënimi për Mehdi LIMANIN

Përsa i përket pozitës së të akuzuarit Mehdi LIMANI, Gjykata merre në konsideratë, në lidhje me të gjitha akuzat, rrethanat e përmendura në Nenin 64 të KPPK, dhe në veçanti:

- 1 shkallën e përgjegjesisë penale: shkalla e përgjegjesisë penale është mjaft e lartë, meqë vepra penale është kryer përmes përpjekjeve të ndryshme dhe të përsëritura për të blerë e për të shitur një sasi të madhe armësh dhe municionesh;
- 2 motivet për kryerjen e veprës penale: i pandehuri ka kryer disa tentativa shkëmbimi dhe shitjeje të armëve dhe municioneve, të cilat sugjerojnë se ka qenë qëllimi i tij të krijonte një biznes mbi veprimtaritë kriminale;
- 3 intensiteti i rrezikut apo lëndimi ndaj vlerës së mbrojtur: vlera e mbrojtur e rendit publik konsiderohet që është ndikuar nga tentativa për të siguruar në mënyrë të paligjshme një sasi të madhe armësh dhe municionesh për përdoruesit potencialë;
- 4 rrethanat në të cilat është kryer vepra penale: është theksuar tashmë që vepra penale është kryer me anë të disa tentativave për transaksione të paligjshme;
- 5 sjelljen e shkuar të kryesit të veprës penale: i akuzuari është dënuar tashmë për posedimin e paautorizuar të armëve më datën 17 qershor 2008 mbi bazën e një dënimi me kush prej 6 muajsh;
- 6 deklarimi i fajësisë: gjykata ka marrë në konsideratë deklarinimin e fajësisë së të akuzuarit në lidhje me pjesë të aktakuzës;
- 7 rrethanat personale të kryesit të veprës penale: i pandehuri është babai i gjashtë fëmijëve;
- 8 dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale: i akuzuari ka demonstruar që pjesërisht e ka ndihmuar triedhën e drejtësisë dhe ka treguar gjithashtu një pendim të thellë përpara Trupit Gjyqes.

Për këtë arsye, dënimi do të përcaktohet në mënyrë të arsyeshme si më poshtë vijon:

- burgim për dy (2) vjet e gjashtë (6) muaj për akuzën e Tentativës së “Furnizimit, Transportimit, Prodhimit, Shkëmbimit apo Shitjes së Paautorizuar të Armëve”, në kundërshtim me Nenin 327 (1) dhe 20 të KPPK. Në lidhje me këtë akuzë Gjykata ka marrë parasysh gjithashtu se, në përputhje me Nenin 20 dhe 65 të KPPK personi që tenton të kryejë një veprë penale do të ndëshkohet më pak se kryesi i veprës penale.
- burgim për një (1) vit e gjashtë (6) muaj për akuzën e “Pronësisë, Kontrollit, Posedimit apo Prëdorimit të Paautorizuar të Armëve”, në kundërshtim me Nenin 328 (2) dhe (3) të KPPK. Përsa i përket kësaj akuze Trupi Gjyqes ka marrë në konsideratë, që për arsyet e përmendura më sipër, vepra penale ka përfshirë një sasi të madhe armësh.

Në bae të Nenit 71 të KPPK dënimi unik për të akuzuarin Mehdi LIMANI do të përcaktohet si dënim me burgim prej tri (3) vitesh e gjashtë (6) muajsh.

Koha e kaluar nga i pandehuri në paraburgim do të përfshihet në sasinë e dënimit.

### ***6.2. Dënimi për Skënder MAHMUTIN***

Sa për të akuzuarin Skënder MAHMUTI, Gjykata merr në konsideratë gjithashtu të gjitha rrethanat e përmendura në Nenin 64 të KPPK dhe në veçanti:

- 1 shkallën e përgjegjësisë penale: shkalla e vogël e përgjegjësisë penale për të akuzuarin varet nga rrethana që ai ishte i përfshirë vetëm në një incident të vetëm të vogël;
- 2 motivet për të kryer veprën penale: i pandehuri deklaroi që sasia e municioneve nuk ishte për t'u blerë për qëllimet e tij, por ishte për një ceremoni dasme;
- 3 intensiteti i trezikut të vlerës së mbrojtur: vlera e mbrojtur nuk është trezikuar seriozisht, megjë blerja aktuale e municioneve nuk ka ndodhur, dhe ajo ka përfshirë vetëm një sasi të vogël municioni;
- 4 rrethanat në të cilat është kryer vepra penale: ai ka qenë një incident i vogël që ka përfshirë një sasi të vogël municionesh;
- 5 sjellja e kaluar e kryesit të veprës penale: nuk ka asnjë provë që i pandehuri ka kryer më parë veprimtari të tjera kriminale;
- 6 deklarami i fajësisë: i pandehuri nuk e ka deklaruar fajësinë, por ai ka pranuar të ketë bërë një urdhr për blerjen e plumbave në fjalë;
- 7 rrethanat personale të kryesit të veprës penale: i pandehuri është i një moshe të re;
- 8 dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale: i pandehuri i ka përmbyshur detyrimet e paraburgimit shtëpiak të vendosur ndaj tij dhe ka pasur një sjellje bashkëpunuese gjatë shqyrtimit kryesor.

Gjykata ka marrë gjithashtu në konsideratë, në përputhje me Nenet 20 dhe 65 të KPPK, që personi që tenton të kryejë një veprë penale do të ndëshkohet më pak se kryesi i veprës penale, kështu që dënimi për akuzën e Tentativës së "Furnizimit, Transportimit, Prodhimit, Shkëmbimit apo Shifjes së Paautorizuar të Armëve", në kundërshtim me Nenet 327 (1) dhe 20 të KPPK, do të përcaktohet në mënyrë të drejtë me burgim prej gjashtë (6) muajsh.

Koha e kaluar nga i akuzuari në paraburgim dhe në paraburgim shtëpiak, do të përfshihet në sasinë e dënimit.

### ***6.3. Dënimi për Ramush KUTLESHIN***

Në lidhje me pozitën e të akuzuarit Ramush KUTLESHI, Gjykata merr në konsideratë të gjitha rrethanat e përmendura në Nenin 64 të KPPK dhe në veçanti:

- 1 shkallën e përgjegjësisë penale: shkalla e përgjegjësisë penale është krejt e ulët, megjë vepra penale përfshiu vetëm posedimin e paautorizuar, dhe jo trafikimin e armëve dhe municioneve;
- 2 motivet për kryerjen e veprës penale: i pandehuri nuk ka dhënë shpjegime të qëndrueshme në lidhje me motivet e posedimit të sendeve të tilla;

- 3 intensiteti i trezikimit apo dënimit të vlerës së mbrojtur: vlera e mbrojtur e rendit publik është ndikuar në mënyrë të lehtë, megjë nuk kishite prova në lidhje me qarkullimin e arsenalit të sekuestruar;
- 4 rrethanat në të cilat është kryer vepra penale: është theksuar tashmë se vepra penale është kryer me anë të posedimit të paautorizuar të armëve dhe municioneve;
- 5 sjellja e kaluar e kryesit të veprës penale: nuk ka prova që i akuzuari të ketë genë i përfshurë tashmë në veprimtaritë kriminale që lidheshin me posedimin e armëve;
- 6 deklaratimi i fajësisë: Gjykata ka marrë në konsideratë deklarinimin e fëjësisë të bërë nga i akuzuari, në lidhje me një pjesë të aktakuzës;
- 7 rrethanat personale të kryesit të veprës penale: i pandehuri është i gjendjes së mesme ekonomike;
- 8 dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale: i akuzuari ka demonstruar që pjesërisht e ka ndihmuar kursin e drejtësisë, me anë të përmbushjes së detyrimeve të paraburgimit shtëpiak të vendosur ndaj tij, dhe me anë të deklarinimit të fajësisë në mënyrë të pjesshme. Ai ka treguar gjithashtu pendim të thellë përpara Trupit Gjykses.

Në lidhje me këtë akuzë Trupi Gjykses ka marrë gjithashtu në konsideratë se, për arset e përmensura më sipër, vepra penale ka përfshirë një sasi të madhe armësh, kështu që dënimi për akuzën e "Pronësisë, Kontrollit, Posedimit apo Prëdorimit të Paautorizuar të Armëve", në kundërshtim me Nenin 328 (2) dhe (3) të KPPK, do të përcaktohet në mënyrë të drejtë me burgim prej një (1) viti

Koha e kaluar nga i akuzuari në paraburgim dhe në paraburgim shtëpiak do të përfshihet në sasinë e dënimit.

## ***7. Shpenzimet e procedurës penale.***

Në bazë të Neneve 102, Paragrafi 1 dhe 3, dhe 391, Paragrafi 1, Pika 6), të KPPPK, të pandehurit, Mehdi LIMANI, Skënder MAHMUTI dhe Ramush KUTLESHTI janë bashkërisht dhe në veçanti përgjegjës për shpenzimet dhe ata duhet të rimbursojnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale.

Në bazë të Nenit 100, Paragrafi 2, të KPPPK, megjë të dhënat në lidhje me sasinë e shpenzimeve mungojnë, do të dorëzohet një vendim i veçantë në lidhje me sasinë e shpenzimeve.

## ***8. Ndërprerja e masave të sigurisë të vendosura ndaj të pandehurve.***

Në bazë të Neneve 393, Paragrafi 1, të KPPPK, trupi gjykses vë re se bazat sipas Nenit 393, Paragrafi 1, të KPPPK, kanë pushuar së ekzistuari në lidhje me të gjithë të pandehurit dhe me anën e një vendimi të veçantë ka përcaktuar se paraburgimi i vendosur ndaj Mehdi LIMANIT dhe paraburgimi shtëpiak i vendosur ndaj Skënder MAHMUTIT dhe Ramush KUTLESHTIT do të anulohen.

Së fundmi, në bazë të Nenit 393, Paragrafi 2, Pika 1, të KPPPK, paraburgimi shtëpiak i vendosur ndaj të pandehurit Sami KUTLESHTI anulohet dhe i akuzuari do të lirohet.

23 January 2009

Kryetari i Trupit Gjykuës  
Tron GUNDERSEN

Anëtari i Trupit  
Sylejman NUREDINI

Procesmbajtësja  
Elisabeth BATMAN



### **Këshillë Ligjore**

Në bazë të Nenit 400 (1) KPPPK, ankesa duhet të shpallet brenda tërë 8 ditësh nga shpallja e këtij aktgjykimi dhe, në bazë të Nenit 398(1) KPPPK, ankesa duhet të dorëzohet në këtë Gjykatë brenda 15 ditësh nga data kur kopja e këtij aktgjykimi i është dorëzuar palëve.

